


## **II. Mbi “Mekaniken” Qeverisese.**

- 1. Hyrje: Per nje qeverisje te mire apo te keqe.**
- 2. Vendimmarrja demokratike (Vleresimi i sistemit demokratik nepermjet “mekanikes qeverisese”).**
- 3. Për një qeverisje të mirë  
Kufizime demokratike të pushtetit ekzekutiv.**

# **II. 1. Hyrje.**

## **Për një qeverisje të mirë.**

Kontroll politik nga njerez te thjeshte apo nga turma.



# Republikë apo/ose Demokraci?

- **Cila qeverisje është më e mirë? Idealizmi: Qeverisje e mbështetur tek virtuti** (Platoni, Aristoteli).
- **Aristoteli, Politika, Libri 7:1,**  
...në lidhje me faktin se cila qeverisje është më e mirë, duhet fillimisht të përcaktohet se çfarë mënyre jetese është më e zgjedhshme, ...është tepër e mundshme që ata që gëzojnë një qeverisje më të mirë do të jetojnë shumë më të lumtur...se secili gëzon aq shumë lumturi sa ai zotëron virtut dhe mençuri...sepse çfarëdo që është e drejtë, e mençur apo prudente për një njeri, është po ashtu e drejtë, e mençur dhe prudente për qytetin...
- **Politika, Botimi shqip, Konica 2003**  
ose : **Politics** By Aristotle  
Written 350 B.C.E , Translated by Benjamin Jowett
- <http://classics.mit.edu/Aristotle/politics.7.seven.html>

# Hegeli mbi Aristotelin

- Ne librin e tij “Aristoteli” (Georg Wilhelm Friedrich Hegel , Aristoteles, Botimet Dritan, Tirana, 2003- Sipas botimit të pas vdekjes të vitit 1833 “Leksione mbi historinë e filozofisë”), Hegeli në paragrafin “Njeriu si kafshë politike dhe politika si Qëllimi suprem i sferës praktike” (f.147-149), duke folur për politikën e Aristotelit, ai shpjegon që për atë **“realiteti i nevojshëm praktik dhe pozitiv, organizimi dhe realizimi i shpirtit praktik, substanca dhe realizimi i tij është Shteti në tërësinë e vet. Aristoteli e ka ndier të gjithë këtë në një mënyrë pak a shumë të qartë”**...Dhe më tej, ai shton “Qëllimi i shtetit është lumturia universale, në përgjithësi. Aristoteli e pranon se Etika e prek edhe individin e vetëm, po përmbushet në popull. Përkundrazi, ai i njeh Shtetit një vlerë kaq të lartë sa e përkufizon njeriun si **“kafshë politike e pajisur me arsye; prandaj vetëm njeriu, jo kafsha, ka vetëdijen e së mirës e të së keqes, të së drejtës e të së padrejtës.”** (f.147)
- Sipas Hegelit, koncepti i Aristotelit mbi shtetin është “diametralisht i kundërt me parimin modern që nisët nga individi, sipas të cilit gjithkush jep votën dhe vetëm kështu ndërtohet një bashkësi shtetërore. Tek Aristoteli, Shteti, përkundrazi, është Thelbësorja, gjëja kryesore; dhe gjëja më e shkëlqyer është politika *dynamis* e realizuar nëpërmjet veprimtarisë së subjekteve të veçantë dhe kjo e fundit sheh në Shtetin e saj, Esencën e saj. Prandaj, sfera politike është këtu sfera supreme, ngaqë në perspektivën praktike Qëllimi i saj është Qëllimi suprem dhe Qëllimi është aq më i ngritur sa më e shkëlqyer të jetë e Mira. **“Kush do të ishte i paaftë për këtë lidhje, apo për shkak të autonomisë së vet, të mos ia ndiente nevojën, do të ishte ose një bishë e egër ose një perëndi.”**” (f.148). Nisur nga kjo, Hegeli, pohon se “Edhe tek Aristoteli si të Platoni, Politikani është *prius*. Sot është vullneti i veçantë (arbitri) i individit ai që kuptohet si *prius*, si absolut, dhe ligji duhet të jetë ai që vendosin të gjithë të veçantët”...
- Në paragrafin “*Excursus* i shkurtër mbi ndryshimin mes Shtetit të lashtë e Shtetit modern” (f. 149-150) Hegeli sqaron se “Aristoteli nuk mund ta kishte idenë e një të ashtuquajturë të drejtë natyrore (në rast se dikush ankohet për mungesën e saj tek Aristoteli),- ai, pra, nuk e konsideronte njeriun abstrakt, jashtë lidhjes së tij reale [me Shtetin]. Nga ana tjetër “Politika” e tij përmban vlerësime edhe sot mjaft domethënëse mbi njohjen e momenteve të brendshme të Shtetit dhe, për më tepër, përshkrimin e kushtetutave të ndryshme. Asnjë vend nuk ka qenë i pasur sa Greqia me kushtetuta të shumëllojshme dhe me aq shumë modifikime të lëndës kushtetore në brendësi të të njëjtit Shtet;...dhe, në të njëjtën kohë, asnjë Vend nuk ka qenë i paditur në lidhje me të drejtën abstrakte të afirmuar në Shtetet moderne, ajo e drejtë që i izolon individët, i lë të qëndrojnë në fuqi si të tillë (prandaj vlera esenciale është rivendosur te personi) dhe që, megjithatë, si një shpirt i padukshëm, i mban të bashkuar të gjithë... ” (f. 149)

- Dhe pak më tej, Hegeli pohon: “ **Vetëm popujt e lirë kanë vetëdije dhe veprimtari për të arritur të Gjithën...** Kur Shtetet e mirëpritën brenda vetvetes këtë parim, mundi të lindte liria më e lartë. Shtetet e lashta janë lojëra e prodhime natyrore, rastësi e kapriço të individëve; në Shtetet moderne, përkundrazi, ka një koherencë të brendshme dhe një Universalitet të pashkatërrueshëm, i cili është real dhe i konsoliduar në pjesët e veta.
- **Parimi aristokratik i Aristotelit.** Në këtë paragraf, Hegeli sqaron se “në ndryshim nga Platoni, Aristoteli nuk është zgjatur në përshkrimin e detajeve të një Shteti. Në lidhje me Kushtetutën shtetërore, ai thekson vetëm **se në drejtim duhet të jenë më të mirët**, - dhe kjo ndodh gjithnjë, sido që të bëhet: prandaj ai nuk ndalet gjatë në përcaktimin e formave të kushtetutës politike: “Më të mirëve do t’u bëhej një padrejtësi, nëse do të barazoheshin me të tjerët më inferiorë se ata në virtyt dhe aftësi politike. **Në fakt, një njeri i tillë i shkëlqyer ngjan me një perëndi mes njerëzve**”. (f.150-151)
- Sipas Hegelit “këtu, Aristoteli mendonte pa dyshim për Aleksandrin e tij, i paracaktuar të zotëronte si një perëndi, pra të mos i nënshtrohej askujt, as ligjit: “**Për të nuk ka ligj, pasi ai vetë është ligji. Mund të dëbohej ndoshta nga Shteti, po nuk do të sundohet nga askush, ashtu siç nuk sundohej Jupiteri. Përpara një njeriu të tillë nuk mbetet gjë tjetër veçse të bindesh me dëshirë – që është në natyrën e gjithkujt – pasi njerëz të tillë mbeten sovranë të përjetshëm nëpër Shtete**””. Por, nisur nga analiza e Hegelit, “demokracia greke tashmë ishte tërësisht e shpërbërë, prandaj Aristoteli nuk mund t’i jepte më asnjë vlerë asaj”.

# Realizmi: Qeverisje në bazë të interesave

## Makiaveli (Niccolo Machiaveli) ne Princi

**Kap.15, Ai thekson se “shumë autorë kanë ndërtuar republika imagjinare dhe principata që nuk kanë ekzistuar kurrë dhe nuk do të ndeshen në praktikë...sepse hendeku midis mënyrës se si njerëzit sillen aktualisht dhe se si ata duhet të silleshin është aq i madh saqë çdonjëri që injoron realitetin e përditshëm me synimin e jetësimit të një ideali do të zbulojë menjëherë se ashtu ai është mësuar që të shkatërrojë veten, jo ta mbrojë, ta ruajë atë. Kështu, gjithsecili që dëshiron të veprojë si një njeri i mirë në të gjitha rrethanat ku përplaset, do të duhet në fakt që të veprojë në mënyrë të kundërt për të shmangur shkatërrimin e tij. Pra, është e domosdoshme për një sundimtar, nëse do ta mbajë, ta ruajë pushtetin e tij, ai duhet të mësojë se si të sillet keq...**

**Kap. 18.**

**...një udhëheqës (sundimtar) i mençur nuk mundet dhe as nuk do ta mbajë fjalën kur ajo është në kundërshtim me interesin e tij. Natyrisht, nëse njerëzit do të ishin të mirë, kjo këshillë do të ishte e keqe, por përderisa njerëzit kanë vese dhe shkelin besimin e dhënë ndaj jush, njëlloj ju nuk keni arsye që t’ u besoni atyre...**

**... një sundimtar (udhëheqës) nuk ka nevojë të gëzojë të gjitha cilësitë pozitive...por ai duhet të shfaqet sikur i ka të gjitha ato...Ai duhet të shfaqet, pra, për të gjithë njerëzit që e dëgjojnë dhe vëzhgojnë atë, një individ krejtësisht i përshpirtshëm, besëtar, simpatik dhe fetar...sepse populli e ndërton gjykimin e tij sipas pamjes së jashtme. Kështu, nëse një sundimtar (udhëheqës) i fiton luftërat dhe e ruan, e mban pushtetin, për të gjitha këto raste mjetet që shfrytëzohen prej tij gjykohen si të ndershme, madje secili duhet t’ i thur atij lavde...**

# Disa citime te tjera

**Civil Disobedience (Mosbindja civile)**, Henri David Thoreau (1817-1862) Dover Publications, Inc., New York, 1993.

- Në përgjithësi, **“një bashkësi nuk ka konshiençë, ndërsa një bashkësi njerëzish të ndërgjegjshëm rezulton dhe si një bashkësi me konshiençë”** (, H. D. Thoreau (1817-1862))
- **Ekzistojnë 999 patronë të virtutit për një njeri me virtut, ndërkohë që është shumë më e lehtë të kesh të bësh me zotëruesin e vërtetë të diçkaje sesa me një ruajtës të përkohshëm të saj.**
- **Zhak-Zhak Rusoi në traktatin e tij “Kontrata Sociale” midis të tjerash nënvizon:**
- **“...mënyra me të cilën trajtohen çështjet e përgjithshme mund të japë një tregues mjaft të sigurt për gjendjen aktuale të zakoneve dhe të shëndetit të trupes politike. Sa më shumë që të mbretërojë marrëveshja nëpër asamblëtë, domethënë sa më shumë mendimet t’i afrohen unanimitetit, aq më shumë vullneti i përgjithshëm është mbizotërues. Por debatet e zgjatura, përçarjet, rrëmuja, paralajmërojnë mbizotërimin e interesave të veçanta dhe të tatëpjetën e shtetit.”**
- **“...kur edhe interesi më i ulët stoliset pa pikë turpi me emrin e shenjtë të së mirës publike, atëherë vullneti i përgjithshëm bëhet memec.”**



# Liberalizmi sipas Lokut

- **Sipas Lokut:**

Vihet në pikëpyetje e drejta divine e mbretërve

- **Gjendja natyrore (state of nature)**

– Liria dhe barazueshmëria absolute

- Të drejtat natyrore: **Jeta, liria dhe prona.**

- **Kontrata sociale**

- **Qeverisja e kufizuar:**

Me degë legjislative dhe ekzekutive

## E drejta për revolucion.

- Liria është natyrore- jo një dhuratë prej shtetit

- Ndërsa, **Liria angleze mbrohet nga ndarja e fuqisë nëpërmjet: Monarkut, parlamentit, dhomës së ulët dhe asaj te Lordëve.**

# Liberalizmi Klasik

## 3 kolonat e liberalizmit klasik:

- Barazia amerikane
  - Liria angleze
  - Virtuti kristian
- 
- Liria mund të shkatërrohet nga **prania e korrupsionit**
  - Liria kërkon një qeverisje nga të virtutshmit, me qëllim që të shmanget **korrupsioni** dhe **tirania**.
  - (Virtuti ndodhet jashtë qendrave të fuqisë).

# Barazia amerikane

- **“Të gjithë njerëzit kanë lindur të barabartë”**
- Të shmangët statusi dhe privilegjet, të pa mbështetura nga ndonjë meritë.

**Egalitarizmi:** Të eliminohet çdo lloj statusi i paarsyeshëm që prodhon dallime.



# Disa pikëpamje (“ideologjike”) moderne amerikane

- **Liria Ekonomike** përkundrejt **Barazisë**

- Vlerat tradicionale përkundrejt lirisë individuale
- Vlerat patriotike përkundrejt vlerave kozmopolite.

## **Konservatorët** (“socialë”):

**Vlerat tradicionale – parësore,  
Liria ekonomike- dytësore.**

## **Liberalët “klasikë”** (“ekonomikë”):

- **Liria ekonomike - parësore**
- **Vlerat tradicionale – dytësore**

## **Progresistët liberale** (parësore barazia dhe liria)

- Statusi individual dhe pasuria (të ardhurat) duhet të mbështeten në kontributin personal
- Shoqëria duhet të synojë **të mënjanojë diferencat në statusin midis individëve që nuk bazohen mbi meritën. E mira apo e drejta demokratike këkon shmangien e të gjitha dallimeve të paarsyeshme (të pamërituara) midis individëve.**

# Kozmopolitizmi dhe konservatorizmi i ri

- Kozmopolitizmi dhe konservatorizmi i ri
- Rikthimi i egalitarizmit
- Ritheksimi i sekularizmit
- Zvogëlimi i kërcënimit komunist

## **Kozmopolitizmi i ri** (Pas Lufta e Dytë Botërore)

- Aleancat e kohës së luftës
- **GATT**: Marrëveshje e Përgjithshme mbi tarifat dhe tregtinë.
- **Breton Woods**
  - OKB-ja
    - KS (Këshilli i Sigurimit)
    - Organizata Ndërkombëtare dhe Gjykata
    - FMN-ja
  - BB-ja
- NATO

## **Konsevatorizmi i ri**

- **Kontrolli i ekonomisë**
- E drejta e grupit mbi të drejtat individuale.
- Ridoli fuqishem ne skene gjate krizes financiare

# Liria angleze

- **Sundimi i ligjit**

- Ligji duhet të jetë i arsyeshëm
- Ligji duhet të jetë i barabartë
- Ligji duhet të jetë i parashikueshëm

Jo ndryshime arbitrare në rregullat e funksionimit dhe të detyrimit të tij.  
Ligjet *ex post facto*.

## Liritë politike:

- Kushtetutë e shkruar (si kontratë midis popullit dhe shtetarëve (sundimtarëve), përfshirë të drejtën e revolucionit)
- Ndarja e Fuqisë
- Jo fuqi sovrane e vetme
- Ligji (Bill) i të drejtave të njeriut
  - Liritë individuale mbrohen nga qeveria
- Rotacioni i pushtetit
  - Jo trashëgimi apo sundim efektiv i pandërprerë

## Liria ekonomike:

- Qeveria përcakton dhe mbron pronën private, ndjek kontratat, stabilizon sistemin monetar.
- Qeveria nuk merret me rregullimin e çmimeve dhe të rrogave, nuk interferon në treg.

# Virtutet Kristiane

- U tejtheksuan virtutet kristiane **si kundërvënie ndaj korrupsionin, degjenerimit njerëzor, marrjes së anëshme të kënaqësisë dhe shfrytëzimit të dhunës pa u kujdesur për sigurinë e të tjerëve.**
- **Parimi baze: Feja mund të kontrollojë dhe civilizojë njerëzit.**

# Teori (“materialiste”) të interesave intelektuale apo kolektive

- Sjellja politike përcaktohet nga ajo ekonomike:
  - Kushtet materiale janë përcaktuese
  - Mirëqenia lidhet kryesisht me prodhimin e shpërndarjen e të mirave materiale (ekonomike)
  - Interesat materiale dhe lidhjet përkatëse ekonomike kushtëzojnë shumicën e rezultateve sociale dhe politike
  - Lidhjet ekonomike krijojnë ndikime dhe kontroll (fuqi) të disa elitave mbi të tjerat
  - Sjellja elitare është çelësi për të kuptuarit e shoqërisë dhe të politikës.
- Në lidhje me relacionet ekonomike dallohen:
  - **Teoria e zgjedhjes racionale**, që e shpjegon sjelljen politike me anë të dinamikës së **interesave elitare individuale** (politikanëve, burokratëve, organizimeve të interesit e lobingut në kuadër të garës së tregut).
  - **Teoria marksiste e radikale**, që e shpjegon sjelljen politike me anë të dinamikës së **interesave kolektive** ( më saktë: **luftës së klasave**)
- **Karl Marks, Manifesti Komunist**

**Historia e të gjitha shoqërive që kanë ekzistuar deri tani është një histori e luftës së klasave...**

**Njeriu i lirë dhe skllavi, patrici dhe plebeu, lord dhe shërbyesi,..., shtypësi dhe shtypësi janë ndodhur në një opozitë konstante ndaj njëri tjetrit, ne nje bote që mbart një luftë të pandërprerë, herë të fshehur herë të hapur...**

**Koha e jonë e ka thjeshtëzuar antagonizmin e klasave. Shoqëria si e tërë është duke u copëtuar gjithmonë e më shumë në dy kampe të mëdha armiqësore, në dy klasa të mëdha, që janë duke u përballuar me njëra tjetrën: **Borgjezinë dhe Proletarin.****



# Pseudo “Lufta e Klasave”

- Ndryshe nga teoria e Lokut e vlerës, në qendër të teorisë ekonomike vendoset **teoria e Marksit e vlerës dhe e mbivlerës.**
  - **Borgjezia**
    - Zotëruesit e mjeteve të prodhimit
    - Klasa sunduese
    - Klasa kapitaliste
  - Prona Private
  - Shfrytëzimi
- **Borgjezia/proletariati**
  - Dinamika e interesave kolektive (të grupit)
  - **Konsiderohen vetëm interesat e borgjezisë**
    - Institucione qeverisjeje për borgjezinë
    - Kulturë mbizotëruese borgjeze
    - Ide të pranueshme për borgjezinë
  - **Nuk konsiderohen interesat e punëtorëve(proletarëve)**
    - Bashkësi (klasë) që punon
    - Klasë që shfrytëzohet
    - Pararojë e revolucionit
      - Intelektualët

## **Pretendime:**

- Eliminimi i të gjitha ndryshimeve sociale që krijon një status te privilegjuar
- **Fundi i të gjitha relacioneve të fuqisë.**

# Edhe njëherë

- **Një ideologji është një bashkësi besimesh, qendrimesh e sjelljes mbi proceset dhe institucionet politike, sociale e ekonomike.** Zakonisht një ideologji ofron një kritikë të sistemit ekzistues përkundrejt një pamje të një sistemi ideal sipas ideologjisë përkatëse, përfshirë dhe lëvizjen përkatëse. Disa ideologji kryesore janë:

**Konservatorizmi**- shpreh **akumulimin e përvojës dhe dijes** nga gjenerata në gjeneratë

**Liberalizmi**- ndryshe nga konservatorizmi (si besnikëria, patriotizmi, etj.) ai shpreh **një pamje egalitare**. Sipas tij qytetari i zakonshëm duhet dhe mund të luajë rol në përmirësimin apo ndryshimin e sistemit politik.

**Socializmi**- lidhet me **sociabilitetin natyror** të individit. Sipas kësaj ideologjie një nga shqetësimet e saj është minimizimi i vuajtjeve të shkaktuara nga **shfrytëzimi i njeriut prej njeriut**. Në variantin radikal (komunist) mbitheksohen elementë të tillë si: lufta e klasave, kontrolli i shtetit nga klasa punëtore (**diktatura e proletariatit**), etj.

**Fashizmi**- një shfrytëzim i mendimit nationalist të shekullit të 19-të (ndikim i filozofisë së Hegelit (Friedrich Hegel), Niçes (Friedrich Nietzsche), etj.)

Variante të tjera të **“jo ideologjive të kthyera në ideologji”** (Kay Lawson: The Human Polity):

**Feminizmi**

**Nacionalizmi etnik**

**Fondamentalizmi fetar**

# Fareed Zakaria


- Sipas Fareed Zakaria (**E ardhmja e Lirisë. Demokracia joliberalë brenda dhe jashtë vendit,**) IDK, botim shqip, titulli i origjinalit “**The Future of Freedom. The Illiberal Democracy at Home and Abroad,** W. W. Norton&Company, New York-London, 2004) “**Ne jetojmë në një epokë demokratike... Ajo që dikur ishte një praktikë e veçuar e një grushti shtetesh në Atlantikun e Veriut, tashmë është një formë standarde e qeverisjes së njerëzimit. Monarkitë janë vjetëruar, fashizmi dhe komunizmi tërësisht të diskretuar. Madje edhe teokracia islamike s’është veçse pak fanatikë. Për një pjesë të madhe të botës, demokracia është burimi i vetëm mbijetues i legjitimitetit politik...Kur vetë armiqtë e demokracisë përdorin retorikën e demokracisë dhe ia imitojnë ritualet, kjo do të thotë se ajo e ka fituar betejën.**

Ne jetojmë në një kohë demokratike edhe në një kuptim më të gjerë. Fjala “demokraci” vjen nga greqishtja dhe do të thotë “sundimi i popullit”. Gjithandëj ne jemi dëshmitarë të zhvendosjes së pushtetit për poshtë. Unë e quaj këtë “demokratizim”, ndonëse kjo shkon përtej politikës, sepse procesi është i ngjashëm: hierarkitë po prishen, sistemet dikur të mbyllura tashmë po hapen dhe presioni i masave është bërë tani motori parësor i ndryshimeve shoqërore. Demokracia është shndërrur nga një formë qeverisjeje në një mënyrë jetese.” (f.7-8)

Kurse pak më poshtë ai thekson: “**Si në të gjitha dukuritë shoqërore masive, janë të shumta ato forca që ndihmuan për të sjellë këtë valë demokratike: revolucioni teknologjik, rritja e mirëqenies klasës së mesme, rënia e sistemeve dhe ideologjive alternative për organizimin e shoqërisë. Këtyre shkaqeve të mëdha sistematike le t’u shtojmë edhe një tjetër: Amerikën. Rritja dhe dominimi i Amerikës – një vend me politikë dhe kulturë thellësisht demokratike- bëri që demokratizimi të duket i pashmangshëm. Cilatdo qofshin arsyt, vala demokratizuese po i jep efektet e parashikuara në të gjitha fushat. Ajo po rrëzon hierarkira, po fuqizon individët dhe po i transformon shoqëritë në një mënyrë që shkon përtej politikës. Në të vërtetë, ajo çka më shumë shquhet në botën ku jetojmë, është pasojë e idesë demokratike” (f. 8-9)**

# II. 2. Vendimmarrja demokratike

**(Vleresimi i sistemit demokratik nepermjet “mekanikes qeverisese”).**



# Disa Koncepte

- **Organizimet** – Organizim është një trup njerëzish që punojnë së bashku në një mënyrë të strukturuar për të arritur qellime të caktuara. Në rastin e organizimeve politike këto qellime janë politike (grupet e interesit, partitë politike, organizimet e fushatave, lëvizjet revolucionare, bile dhe grupet terroriste në njëfarë mënyre janë organizime të tilla politike)
- **Institucionet**- Një institucion është një strukturë me funksione të rëndësishme me role të mirë-përcaktuar në kryerjen e tyre, me një grup rregullash që mundësojnë relacionet apo marrëdhëniet midis njerëzve në kryerjen e këtyre roleve.
- **Shtetet**- Shteti është një strukturë që ka të drejtën legale për të krijuar dhe zbatuar rregulla (ligje) që shtrihen mbi një popullsi të dhënë brenda një territori të dhënë. Si i tillë ai ka karakteristika sa gjeografike, po aq politike. Pra, shteti është një institucion politik, që sintetizon sovranitetin, pra ai ndryshon nga institucionet e tjera politike- fuqia e tij në vendimmarrje nuk mund të shtrihet mbi grupime apo trupa të tjerë. Ky është dhe kuptimi i sovraniteti.
- **Sistemet**- Sistemi është një strukturë në të cilën të gjitha pjesët e saja janë të ndërthurura, në kuptimin që ndryshimi i njërës nënkupton ndryshimin e të gjitha pjesëve të tjera. Kur ky sistem ka të bëjë me çështje të natyrës politike ai quhet sistem politik: pra, sistem politik është çdo strukturë me pjesë të ndërvarura dhe ndërvepruese që lidhen me çështje politike.


# Pamje të ndryshme të organizimit të **sistemit politik**

Sot veçohen **1. demokracia monarkike kushtetuese** (parlamentare), **2. republika parlamentare**, **3. republika gjysmë-presidenciale** dhe **4. ajo presidenciale** (p.sh., ajo amerikane).

**Monarki kushtetuese** në Evropë janë: Britania e Madhe, Belgjika, Danimarka, Holanda, Norvegjia, Spanja, Suedia, Luksemburgu, Monako, Lihtenshtajni e Andora. Variant tjetër i sistemit politik demokratik në Evropë është **republika gjysmë-presidenciale franceze**. Edhe në raste të forta gjysmë-presidenciale pushteti ekzekutiv ndahet midis kryetarit të shtetit dhe kryetarit të qeverisë, ndërkohë që në sistemin presidencial amerikan presidenti është kryetari i qeverisë dhe i shtetit. Në vende të tjera evropiane sistemi politik demokratik shfaq një variant apo tjetrin **të një republike parlamentare**, diku me kryetar shteti (president) me detyra më të “kopsitura”, diku me profil më honorifik. Republika parlamentare janë dhe të gjitha vendet ish socialiste të Evropës Lindore. Në ndryshim nga vende të tilla si Greqia, Italia, Gjermani, etj., ku presidenti zgjidhet nga parlamenti (Greqi), **nga parlamenti dhe senati** (Itali) apo nga **konventa federative** (Gjermani), etj.; në këto shtete ish socialiste, në shumicën e rasteve, zgjedhja e presidentit bëhet **drejtpërsëdrejti nga populli** (por praktikisht pa prekur thelbin e një republike parlamentare)...

Rasti shqiptar i përket sistemit politik me një republikë të “ekuilibruar” parlamentare (**me një dhomë**). **Zgjedhja e presidentit behet ne Kuvend**. Me ndryshimet e fundit: konsolidimi i pozicionit kushtetues të kryeministrit deri në nivelin e **kancelarit**. (**Shih. R.Meidani. Kushtetuta, etj.**)

**Republika parlamentare ne bote me presidente me fuqi te dobta ekzekutive (ne ngjyre portokalli) dhe presidente me fuqi ekzekutive te lidhur me parlamentin (ngjyra blu e hapur). Ne ngjyre te kuqe jane paraqitur monarkite kushtetuse.**





# Klasifikimi i qeverisjes

Llojet e qeverisjes, sipas rubrikave:

- ❖ organizimit politik, p.sh., atij federal apo unitar;
- ❖ organizimit ekonomik, p.sh., atij kapitalist, atij socialist apo atij me ekonomi te perzjere;
- ❖ shperndarjes se fuqise, p.sh., asaj demokratike, autoritare apo totalitare;
- ❖ tipi i qeverisjes, p.sh. forma monarkike apo republikane, sistemi presidencial apo sistemi parlamentar, etj.



Kur shfrytëzojmë termat **autoritar** apo **totalitar** nuk bëhet fjalë për një sistem besimi apo ideologji, por bëhet fjalë për **sisteme politike ku fuqia politike përqendrohet në pak duar**. Sistemi autoritar është ai ku fuqia e autoriteteve është **virtualisht e pakufizuar, megjithatë kjo fuqi jo patjetër ushtrohet në të gjitha fushat**, Ndërsa në **sistemin totalitar kjo fuqi jo vetëm është e pakufizuar por shtrihet kudo**, si të thuash: **autoritarizmi arrin në ekstrem**.



# Forma bazike qeverisje (**Sisteme qeverisje**):

## **Struktura e Fuqise (per ushtrimin e saj)**

- Unitare**
- Federale**
- Konfederale**
- **Perandori (Fuqi perandorake)**
- **Hegjemoni (Fuqi hegjemone)**

# Burimi dhe menyra e ushtrimit te fuqise.

## Nje klasifikim jo i plote:

### Atribute demokratike:

#### Demokraci

E drejtperdrejte.

Perfaqesuese

### Atribute monarkike

#### Monarki

Absolute

Kushtetuese

Me zgjedhje te monarkut

### Atribute oligarkike

#### Oligarki

Aristokraci

Meritokraci

Junte ushtarake

Plutokraci

Stratokraci (qeverisje e drejtuar nga shefa ushtarake)

Teknokraci

Timokraci

Kritarki (qeverisje nga gjyqtare, p.sh., ne Izraelin e Lashte)

### Atribute autokratike

Autoritarizem - Qeverisje Autoritare

Autokraci

Despotizem

Diktature

Fashizem

Teokraci

Totalitarizem

Komunizem

### Atribute te tjera

Emirate, (njelloj si monarkia apo sulltanati, ku fuqine e ka emiri me pushtet absolut apo me autoritet te kufizuar nga ana kushtetuese)

Republike


Republike Kushtetuese

Qeverisje Tribale

Anarki, etj.

**Shenim:** Republike eshte ajo forme qeverisje ne te cilen vendi konsiderohet si “**ceshtje publike**” (Ne lat.: *res publica*), jo thjesht merak apo prone e udheheqesve. Aty ne zyrat e shtetit vendosen njerez qe zgjidhen drejtpersedrejt apo ne menyre te terthorte ose dhe emerohen, por pa lejuar trashegimimin e posteve te tyre. Ne kohet e sotme, nje perkufizimi i thjeshte per republiken eshte qeverisja ku **kryetari i shtetit nuk eshte monark.**


# Shtetet e botës të ngjyrosur sipas tipit të qeverisjes (prill 2006).



- Republikë e plotë presidenciale.
- Republikë presidenciale me rol të kombinuar të presidentit dhe kryeministrit.
- Republikë gjysmë presidenciale.
- Republikë parlamentare.
- Monarki kushtetuese-parlamentare ku monarku nuk e ushtron pushtetin personalisht.
- Monarki kushtetuese-parlamentare ku monarku e ushtron pushtetin personalisht (shpesh me një parlament të dobët).
- Monarki absolute
- Republikë njëpartiake.
- Diktaturë ushtarake.
- Vend që nuk klasifikohet dot në skemën e mësipërme.

# Sistemi unitar


- Shtet unitar është shteti (vendi) që qeveriset nga ana kushtetuese **si një njësi e vetme, me një legjislature të vetme** (një strukturë legjislative të vetme).
- Sistemi unitar ja jep qeverisjes qendrore të gjithë **autoritetin apo pushtetet kryesore të shtetit**.
- Drejtimi i shtetit, i provincave dhe njesive lokale realizohet, krijohet e organizohet nën **perkujdesjen e qeverisë qendrore**.
- Qeverisjet jo qendrore (vendore) kanë **vetëm** ato fuqi (pushtete) të caktuara nga qeverisja qendrore dhe vazhdojnë të ekzistojnë e funksionojnë për aq kohë që kanë miratimin e qeverisjes qendrore (natyrisht për sistemet demokratike në përputhje me kushtetuten).



**Shtetet unitare.** Mbretëria e Bashkuar konsiderohet si **nje shtet unitar**, ndërsa SHBA- është **nje shtet federal**. Shteti unitar është **nje shtet sovran qe qeveriset nga nje njesi e vetme**, ne te cilen është kryesore qeverisja qendrore dhe ndarjet administrative (njesite nen -kombetare), ushtrojnë vetëm ato fuqi qe u delegohen atyre nga qeverisja qendrore, qe mund te zgjerohet apo ngushtohet nga qendra. Shume shtete kane nje sistem unitar qeverisjeje, ndryshe nga shtetet federale (federatat). **Fuqite politike ne shtetet unitare mund te delegohen nepermjet devolucionit per nga qeverisja lokale. Madje, kjo është prirja e sotme!**

# Sistemi federal (Federata)

- **Sistemi federal eshte ai ku jane bashkuar apo federuar disa shtete ose provinca:** duke krijuar nje strukture te vetme te unifikuar qeverisese per te gjitha territoret perberese.
- Ne qeverisjen federale (ne nje qeverisje ku zbatohet, shfrytezohet sistemi federal), fuqite apo pushtetet qeverisese ndahen **midis qeverise (qeverisjes) qendrore dhe qeverive (qeverisjeve) rajonale** (shteteve, landeve, kantoneve, etj.).
- **Qeverite rajonale kane nje shkalle te caktuar autonomie.**
- Nga pikepamja kushtetuese, qeverisjet rajonale ruajne apo kane **sovrانيتin e tyre kushtetues.**
  - Ne sistemet federale, asamblete e shteteve qe perbejne federaten kane **ekzistence kushtetuese.** Ato ushtrojne nje mori funksionesh kushtetuese, qe nuk mund te ndryshojne apo te amendohen ne menyre te **njeanshme nga qeverisja qendrore.**



**Federalizmi është një koncept politik**, sipas të cilit një grup anëtarësh janë të lidhur midis tyre me një konventë apo marrëveshje (lat.: *foedus*- konventë) me një **kokë përfaqësuese** qeverisëse. Termi federalizëm shfrytëzohet po ashtu për të përshkruar një sistem qeverisjeje në të cilën sovraniteti është i ndarë nga pikëpamja kushtetuese midis një **autoriteti qendror** qeverisës dhe **njësive politike përbërëse** (në trajtën e shteteve, provincave apo landeve). Pra, federalizmi është një sistem ku pushteti qeverisës ndahet midis qeverisjeve qendrore (në nivelin e shteteve, provincave, etj.) dhe qeverisjes kombëtare, duke krijuar atë që quhet federatë.



# Qeverisja amerikane- Federalizmi

## Sistemi federal amerikan.

- Sistemi federal apo federalizmi eshte misheruar ne kushtetuten e ShBA-se, por natyrisht kushtet konkrete politike kane imponuar evoluimin e “doktrines” se federalizmit.

## Mekanika e Federalizmit

- Kushtetuta e ndan fuqine midis:
  - Qeverise (qeverisjes) federale
  - Qeverive (qeverisjeve) te shteteve.
  - Popullit
- Qeveria (qeverisja) federale ka tre tipa fuqie:
  - Te brendshme (inherente)
  - Te deleguar (te enumeruar)
  - Te implikuar (apo te dhene me mirekuptim, me konsensus)
- **Federalizmi kooperativ** (1930-1970) eshte nje koncept i federalizmit ne te cilin **qeverisja kombetare, qeverisjet e njesive shteterore** (shteteve) apo **ato vendore** bashkeveprojne me shume ne menyre kooperative dhe kolektive per te zgjidhur problemet e perbashketa, sesa per te zbatuar politika te vecuara pak a shume te njejta..

# Perberja e 10 sistemeve federale

Burimi: The World Almanac and Book of Facts, 1996,  
(Mahwah, New Jersey: Funk and Wagnalls, 1996), pp. 740-831

- **Australia** 6 shtete, 2 teritore
- **Brazili** 26 shtete, 1 distrikt federal
- **Kanadaja** 10 provinca, 2 teritore
- **Gjermania** 16 shtete
- **India** 25 shtete, 7 teritore unioni
- **Meksika** 31 shtete, 1 distrikt federal
- **Nigeria** 30 shtete, 1 teritor federal (kryeqyteti)
- **Rusia** 21 republika autonome, 49 obllaste dhe 6 njesi te tjera
- **Afrika e Jugut** 9 provinca
- **Zvicra** 20 kantone, 6 gjysme kantone
- **SHBA** 50 shtete, 1 distrikt federal

# Sistemi konfederal (Konfederata)

- **Konfederate** është bashkimi i një numri shtetesh **sovrane**, shpesh të krijuar fillimisht me anë të një **marreveshje ose traktati**, dhe më tej edhe duke adoptuar një **kushtetute të përbashkët**.
- Në sisteme të tilla, fokusimi i përbashkët është për çështje kryesore e kritike si **mbrojtja, politika e jashtme, tregtia e jashtme apo monedha e përbashkët**.
- Në terma bashkëkohore, konfederata nënkupton një bashkim permanent shtetesh sovranë në aksione të tyre të përbashkët ndaj shteteve të tjera apo për përballimin e situatave kritike që prekin njësitë përberëse.
- Qeveria qendrore në një konfederate është e dobët, ndërsa pushtetet apo fuqitë e vërteta ndodhen në duart e njësitë përberëse (nën-kombetare).

# Perandoria

Termi **perandori**, (ne latin. **Imperium** -fuqi, autoritet) politikisht nenkupton nje grup shtetesh dhe popujsh (grupesh etnike) me shtrirje gjeografike te konsiderueshme te bashkuar dhe udhehequr nga nje monark (perandor ose perandoreshe) apo nje oligarki. Pervec perdorimit tradicional te termit, perandori quhet dhe nje biznes me shtrirje te madhe (p.sh., nje korporate transnacionale) apo nje organizate politike (me shtrirje nderkombetare, rajonale, nacionale, apo nivel qyteti), e kontrolluar nga nje person (**nje bos politik**) apo nje autoritet grupor (boset politike).

Nje strukture politike perandorake krijohet dhe mbahet me dy menyra: i) si **nje perandori territoriale** e realizuar nga nje pushtim i drejtperdrejte dhe e kontrolluar nepermjet **forces** (veprimit fizik te drejtperdrejte per te realizuar synimet e perandorit) dhe (ii) si nje **perandori hegjemone koercive** pas nje pushtimi te terthorte dhe kontrolli **fuqie** (perceptimi qe perandori mund te imponohet fizikisht ne plotesimin e qellimeve te deshiruara). Ne rastin e pare garantohet nje respekt me i madh dhe nje kontroll politik me i drejtperdrejte, me shtrirje forcash ushtarake ne garnizone te shtrira ne te gjithë hapësirën. Ne rastin e dyte, behet fjale per me pak “homazh” dhe një kontroll te terthorte, pavarësisht nevojës për forca ushtarake per nje shtrirje te metejshme. **Perandori territoriale** (p.sh., **Perandoria Mongole**) synonte te mbulonte zona ne kontakt me njera-tjetren. Ky term eshte perdorur dhe per perandori “ujore” (**thalassocracy**) si p.sh. **ajo athinase** apo **ajo britanike** me struktura me pak te lidhura dhe terriore me te shperhapura. Gjithashtu, ne keto raste, **ky term pasqyron terriore tepër të shtrira si p.sh., Perandoria Spanjolle (shek. 16) apo britanike (shek. 19).**

# Hegjemonia

**Hegjemonia** është një formë jodirekte qeverisje (udhëheqje apo drejtim) e një dominimi perandorak , ku hegjemoni (**shteti udhëheqës**) drejton shtete të ndërvlarura nëpërmjet instrumentave të ndryshëm të fuqisë, më shumë kërcënimin se përdorimin e një force ushtarake të drejtpërdrejtë. **P.sh., në Greqinë e Lashtë (shek. 8 p.e.s. – shek. 6) hegjemonia nënkuptonte dominimin politik-ushtarak të një qyteti-shtet ndaj të gjithë qytet-shteteve të tjerë. (Rasti i Athinës ne Ligen Deliane )**

Në praktikën e hegjemonisë, zotërimi perandorak është ridimensionuar me anë të imperializmit kulturor, ku shteti udhëheqës (hegjemoni) dikton të gjitha politikat e brendshme dhe karakterin shoqëror-kulturor të shteteve “vasale” që përbëjnë **sferën hegjemone të influencës**, ose me anë të një qeverie të sponsorizuar nga brenda ose me anë të një qeverie të instaluar nga jashtë.

Imponimi i mënyrës së jetës i hegjemonit- nje gjuhe **lingua franca perandorake** dhe burokracitë përkatëse (sociale, ekonomike, edukative, qeverisëse) e shndërron imperializmit konkret të dominimit ushtarak të drejtpërdrejtë në një **fuqi abstrakte status quo-je**, në një dominim të tërthortë perandorak.

Nën hegjemoninë, rebelimi (social, politik, ekonomik apo i armatosur) mënjanohet ose nëpërmjet kooptimit të rebelëve apo shtypjes policore e ushtarake, **pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të hegjemonit**. Të tillë janë shembujt e perandorisë **spanjole** apo **britanike** në fazat e tyre të vonshme, apo **Rahju gjerman** i shek. 19 – shek. 20 (1871–1945).

# Suzereniteti.

**Hegjemonia**, ndryshon jo vetem nga koncepti i *perandorise por dhe ai i suzerenitetit*. Ne rastin e dyte behet fjale per ate **situatë në të cilën një shtet vasal ose një rajon (popullsi) ka kushtëzime apo detyrime ndaj një entiteti apo njësie më të fuqishme**. Është kjo e fundit që i kontrollon atij shteti vasal apo atij rajoni (asaj popullsie) **politikën e jashtme**, ndërkohë që i lejon atij njëfarë **autonomie të brendshme**. Entiteti dominues në këtë marrëdhënie suzereniteti, pra njësia me fuqi më të madhe apo kryetari i shtetit të saj quhet **suzeren**. Ky term është përdorur, p.sh., për të përshkruar marrëdhëniet midis perandorisë osmane dhe rajoneve rrethuese. Të tilla konsideroheshin, p.sh., Moldavia apo Principata e Serbisë në marrëdhëniet me sulltanin. Po ashtu, i tillë është po ashtu feudali të cilit vasalët duhet të paguajnë detyrimet e nderet përkatëse. Edhe pse si koncept ai ka qenë bashkëshoqërues i disa perandorive historike, sot ai, në kuptimin e ligjit ndërkombëtar, ndesh vështirësi të shumta për arsye të dimensionimit të vetë konceptit të sovranitetit. Gjithashtu, *suzereniteti* shpreh pozicionin, mandatin ose autoritetin e *suzerenit*, por dhe zonën hapësinore, shtrirjen e zonës së ushtrimit të këtij autoriteti.

**Ai nënkupton një marrëdhënie midis shtetesh, sipas të cilës shteti i nënshtruar ka qeverinë e tij, por nuk mund të ndër marrë veprime ndërkombëtare të pavarura të shtetit kryesor. Ai ndryshon nga sovraniteti në kualitetin e të zotëruarit të autoritetit suprem dhe të pavarur mbi një hapësirë gjeografike apo territor të dhënë, qe mishërohet në fuqinë e drejtimit dhe bërjen e ligjeve.**

Në gjeopolitikën bashkëkohore është bërë më se e zakonshme që vende të mëdhenj të kujdesen për mbrojtjen dhe marrëdhëniet me jashtë të vendeve fqinjë shumë më të vegjël. Ky lloj raporti ndryshon nga **suzereniteti tradicional** në faktin që njësia më e vogël ka të drejtën ta abrogojë çdo marrëdhënie të tillë me anë të një referendumit përkatës.

**Shembuj të tillë suzereniteti janë, p.sh., binomet: Itali-San Marino, Itali – Vatikan, Francë – Monako, Francë – Andorra, Spanjë – Andorra, etj.**

# San Marino



**San Marino apo Republika e San Marino-s** është një mikro-shtet i rrethuar nga Italia. Zë një sipërfaqe prej 61 km<sup>2</sup> me popullsi dicka mbi 30,000 banorë. Kryeqyteti është Siteja e San Marino-s. Në Këshillin e Evropës ky shtet është anëtar i me popullsi më të vogël. **San Marino është shteti sovran më i vjetri dhe republikë kushtetuese në botë.** Kushtetuta e tij, e futur në fuqi më 1600 është një nga kushtetutat më të vjetra të shkruara akoma në veprim. (Megjithatë, San Marino nuk ka kushtetutë formale, por qeveriset nga Leges Statutae Republicae Sancti Marini, një seri 6 librash, të shkruara në latinisht në fund të shekullit të 16-të, që përcakton edhe sistemin politik).

San Marino është **republikë demokratike përfaqësuese** me **kapitenët regjentë** si kryetarë shteti dhe një system politik shumë-partiak. Fuqia ekzekutive ushtrohet nga qeveria, kurse fuqia legjislative realizohet nga qeveria dhe **Këshilli i Madh dhe i Përgjithshëm** (*Consiglio Grande e Generale*), që është parlamenti i San Marinos, i përbërë nga 60 anëtarë me mandat 5 vjeçar. Aty zgjidhen jo vetëm Kapitenët Regjentë, por dhe Kongresi i Shtetit si dega ekzekutive e qeverisjes. i përbërë nga 10 sekretarë me fuqi ekzekutive, Këshilli i të Dymbëthjetëve që formojnë degën juridike gjatë legjislaturës së Këshillit, etj. Vete dega juridike është e pavarur nga dy degët e tjera, etj. Pra, cdo 6 muaj ky këshill zgjedh **2 Kapitenë Regjentë** si **Kryetarë shteti (nga parti opozitare, për të balancuar fuqinë)** për mandat 6 mujor. Pas mbarimit të tij, qytetarët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesat e tyre ndaj kapitenëve; nëse ato janë shqetësuese fillon procedimi i tyre tashmë si ish kryetarë shteti. Një praktikë e tillë është një trashëgim i Republikës Romake. Këshilli është ekuivalent me Senatin Romak, dhe Kapitenët Regjentë me Konsujt e Romës së Lashtë.

**Së fundi, theksojmë se San Marino është një shtet i asociuar me Italinë. Eshte kjo e fundit që përgjigjet për mbrojtjen e San Marino-s.**





# Vatikani

**Vatikani apo Shteti i Citesë së Vatikanit** (në italisht: *Stato della Città del Vaticano*) është një qytet-shtet sovran me një territor të rrethuar me mur brenda qytetit të Romës. Ai ka një sipërfaqe afro 44 hektarë dhe një popullsi pak mbi 800 vetë, ndryshe nga përkatësia katolike që kalon numrin e 1.2 miliardë ndjekës në të gjithë botën. Si i tillë, shteti i pavarur i Vatikanit është dhe shteti më i vogël në botë sipas sipërfaqes dhe popullsisë. **Ai u krijua në vitin 1929, sipas një marrëveshje midis Mbretërisë së Italisë dhe Selisë së Shenjtë dhe të miratuar nga parlamenti italian.** Ai u përfshi pas luftës (në vitin 1947) në Kushtetutën Demokratike të Italisë.



**Shteti i Vatikanit është shtet teokratik (“monarkik”-ekleziastik) i drejtuar nga kardinali i Romës- Papa e Romës.**

# Principata e Andorrës

**Ajo është themeluar më 1278.** Rolin e monarkut e kryejnë së bashku dy **ko-princa**: **Kardinali i dioqezës katolike të Katalanjës** (vetë principata është pjesë e asaj dioqeze) dhe **Presidenti i Francës**. **Andorra është një ko-principatë parlamentare.** Kjo veçori e bën Presidentin e Francës, në kapacitetin e tij si Princ i Andorrës, **një monark të zgjedhur** (por jo të zgjedhur me votën e popullit të Andorrës!). **Sistemi politik i Andorrës është shumëpartiak dhe inkuadrohet në atë të një demokracie parlamentare përfaqësuese** (Parlamenti quhet Këshilli i Përgjithshëm). **Fuqia ekzekutive ushtrohet nga qeveria dhe kryeministri është kryetari i qeverisë.** Ndërsa, fuqi legjislativë kanë si parlamenti ashtu dhe qeveria. Gjyqësori përbëhet nga gjykata e magjistratëve, gjykata penale, gjykata e lartë dhe gjykata kushtetuese.

Andorra



Andorra nuk ka forca të armatosura me përjashtim të një trupe ceremoniale. Përgjegjësinë për mbrojtjen e këtij vendi e kanë Franca dhe Spanja. Megjithatë, në raste emergjencash apo fatkeqësish natyrore, me dhënien e alarmit (*Sometent*) thirren në shërbim të gjithë burrat e moshës 21-60 vjeç të **nacionalitetit andorras**. Kjo është arsyeja që andorrasit, sidomos kryefamiljarët, duhet të mbajnë me ligj një armë, madje ligjërisht dhe policia në rast nevojë u ofron armë qytetarëve. **Andorra është anëtare e OKB-së, anëtare e OSBE-së dhe ka një marrëveshje të veçantë me BE-në. Si monedhë e saj është euro.**

# Monako



**Monako (Principata e Monakos)** është një **qytet-shtet sovran**. Ka një sipërfaqe 1.98 km<sup>2</sup> (me zgjerimin e portit në det 2.05 km<sup>2</sup>) dhe popullsi afro 37,000 banore, pra me dendësinë më të madhe në botë. Zona më e populluar është Monte Karlo. Sovraniteti i shtetit është njohur zyrtarisht në **Traktatin e vitit 1861 Francë- Monako**. Më 1993 Monako është bërë anëtare e OKB-së. Megjithëse Monako është shtet i pavarur dhe me politikë të jashtme të vetën, mbrojtja e tij është **përgjegjësi e Francës**. Megjithatë, ai ka dy njësi të vogla ushtarake.

**Monako është monarki kushtetuese** (që prej **vitit 1911**) me monark Princin Albert II si kryetar shteti, me Këshill Qeverisës me 6 anëtarë. Ministri i Shtetit, deri në vitin 2002, ka qenë qytetar francez i emëruar nga princi midis kandidatëve të qeverisë franceze, ndërsa pas amendamentit kushtetues përkatës të vitit 2002, ai mund të jetë francez apo vendas. Ai drejton këshillin dhe 5 anëtarë, ka të drejtë vote dhe kontrollon policinë (me 515 vetë) dhe njësitë ushtarake (225 vete). Detyrat në këshill janë ndarë midis **1. çështjeve të brendshme, 2. financës dhe ekonomisë, 3. mjedisit, planëzimit urban dhe furnizimit me pajisje (industrive pa ndotje) , 4. çështjeve sociale dhe shëndetit dhe 5. marrëdhënieve të jashtme**. Sidoqoftë, princi është monark kushtetues, ai ka ende fuqi politike të konsiderueshme.

## -2-

Sipas kushtetutës së vitit 1962, princi **ndan fuqinë e vetos me Këshillin Kombëtar njëdhomësh**. 24 anëtarët e tij zgjidhen për mandat 5-vjeçar, 16 në mënyrë të drejtpërdrejtë, kurse 8 nga pjesa proporcionale.

Shteti nuk ka taksa për të ardhurat vetjake apo të biznesit të vogël, madje konsiderohet si një parajsë taksash. GDP për frymë është më e larta në botë (nominalja \$172,676 dhe ppp-ja \$186,175). Monako ka moshën mesatare të pleqërisë më të lartën në botë: 90 vjeç për burrat dhe 94 për gratë, kurse përqindjen e papunësisë 0%.

**Verejtje:**

**Vlera nominale:** vlera e mallrave dhe e shërbimeve të prodhuar brenda një vendi gjatë një viti, e konvertuar me vlerën e tregut të dollarit (të kursit të këmbimit), pjesëtuar me popullsinë mesatare të vitit.

**Vlera ppp** (purchasing power parity): vlera e mallrave dhe shërbimeve të prodhuar brenda një vendi gjatë një viti të dhënë e pjesëtuar me popullsinë mesatare të vitit.

# Protektorati

Termi *protektorat* ka, në histori, dy kuptime të ndryshme. Në variantin më të hershëm, të adoptuar edhe në ligjin bashkëkohor ndërkombëtar ai nënkupton një territor autonom të mbrojtur në mënyrë diplomatike e ushtarake kundër të tretëve nga një shtet apo entitet më i fortë. Në këmbim të kësaj, protektorati pranon zakonisht disa detyrime specifike, që mund të variojnë në varësi të natyrës reale të marrëdhënieve të tyre. **Megjithatë, ai ruan një farë sovraniteti formal dhe konsiderohet si shtet nën ligjin ndërkombëtar. Një subjekt territorial i tillë njihet edhe si shtet i mbrojtur (*protected state*).**


Një kuptim i dytë iu dha protektoratit gjatë ekspansionit kolonial evropian në shekullin 19-të. Shumë territore të kolonizuara u konsideruan si “**protektorate koloniale**”, por pa u konsideruar **si shtete të veçanta nën ligjin ndërkombëtar**. Ndërsa, entitetet e emërtuara si “**protektorate ndërkombëtare**” shpesh bëhen tepër të varura nga fuqia (fuqitë) mbrojtëse dhe praktikisht e humbin **pavarësinë e tyre shtetërore**.

Një rast protektorati ndërkombëtar ka qenë dhe ai i Kosovës, ku, më 1999, në përputhje me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, u instalua administrata ndërkombëtare e OKB-së apo **UNMIK (*United Nations Interim Administration Mission*)**. Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj. Serbia dhe disa vende të tjerë vazhdojnë të mos e njohin Republikën e Kosovës si shtet i pavarur, por si entitet të qeverisur nga OKB-ja.



# Raste evropiane

- **Mbreteria e Bashkuar**, edhe pse ne ndonje rast konsiderohet diku midis asociacionit apo devolucionit, ne shume parametra kryesore duhet te konsiderohet si shtet unitar. 4 perberese e saj, krahas Anglise, jane Skocia, Uelsi dhe Irlanda e Veriut. Aty ndeshet **nje shkalle e konsiderueshme autonomie ne qeverisje**. Ky devolucion shihet: ne Skoci, **me qeverine skoceze dhe parlamentin skocez**; ne Uels me **qeverine e Asamblese te Uelsit dhe Asamblene Kombetare te Uelsit**; ne Irlanden e Veriut me **ekzekutivin e Irlandes se Veriut dhe Asamblene e Irlandes se Veriut**. Por kjo fuqi e devoluar eshte e deleguar nga qeverisja qendrore britanike, me specifikesht nga parlamenti i Mbreterise se Bashkuar, qe eshte **pushteti suprem sipas doktrines se supermacise parlamentare**. Per me tej, qeverisjet e devoluara nuk mund te sfidojne kushtetutshmerine e akteve te Parlamentit, bile fuqite e qeverisjeve te devoluara mund te revokohen apo redukohen nga qeverisja qendrore (Parlamenti me qeverine e perbere nga kabineti i drejtuar nga Kryeministri). **Keshtu, p.sh., Asambleja e Irlandes se Veriut eshte pezulluar ne kater raste, me kalimin e fuqive tek Zyra e Qeverisjes Qendrore e Irlandes se Veriut**.
- Ne shtetet federale, shtetet apo njesite nenkombetare ndajne sovranitetin e tyre me qeverisjen qendrore. Keto shtete apo njesi te federates kane nje ekzistence dhe funksione fuqie qe nuk mund te ndryshohen apo preken ne menyre te njehanshme nga qeverisja qendrore. Ne disa raste, si SHBA, qeveria federale gezon vetem ato pushtete qe i jane deleguar asaj. Aty, sipas kushtetutes, fuqia ndahet midis qeverise federale dhe shteteve te vecanta. Shume shtete federale kane gjithashtu nivele te ulet qeverisjeje. Keshtu, SHBA eshte nje shtet federal, por vete shtetet e vecanta kane konte dhe municipalitetet qe **gezojne vetem ate autoritet te dhene per ta nga qeverisjeve te ketyre shteteve te vecanta, sipas kushtetutes se shtetit apo nje akti legjislativ**.
- Shume vende ne sistemin “Westminster” te qeverisjes jane shtete unitare me perjashtim te Australise, Kanadase, dhe Malajzise, qe **kane sisteme federale**. Keto kombe (vende) mund te konsiderohen hibride te dy sistemeve, duke aplikuar **centralitetin e sistemit unitar ne nivelin federal, dhe ndarjen e fuqise me shtetet e vecanta, provincat dhe territoret qe ndeshen ne sistemet federale**.
- **Devolucioni si federimi mund te jete simetrik apo asimetrik**.



Sipas strukturës:

- Shtet unitar
- Shtet i devolvuar
- "Federasia"
- Shtet i devolvuar dhe njëkohësisht "federasi"
- Federatë


Ne nje klasifikim pa "federasi", ato konsiderohen thjesht unitare

"**Federasia**" (aleanca apo asociacioni i nje grupi i anetaresh apo vendesh) është një **formë e qeverisjes** ku një apo disa njësi nënshtetërore gëzojnë shumë më tepër pavarësi se shumica e njërive të tjera, ndryshe e thënë, këto pjesë përbërëse të shtetit janë autonome. **Pra, ajo shfaq si veçori të federatës ashtu dhe të një shteti unitar.** Në njëfarë mënyre, një organizim i tillë mund të konsiderohet si i ngjashëm me një **federalizëm asimetrik.**


**Raste europiane:** Danimarka me Grinlandin dhe Ishujt Faroe; Finlanda me arkipelagun Åland me nivel të lartë autonomie (që në vitin 1920); Franca me 26 rajone (22 europiane), 4 rajone përtej detit dhe 4 kolektivitete dhe një territor përtej detit; Mbretëria e Holandës me 3 pjesë, Holanda, Antilet Holandeze dhe Aruba. Edhe Portugalia ka dy rajone autonome si Azores dhe Madeira (por shihet ende si unitare). Vete Mbretëria e Bashkuar, që në thelb konsiderohet si shtet unitar, e ka njëkohësisht kete karakter "federasi" dhe devolvimi.

Vendet anetare sipas  
formes se qeverisjes

- Republika  
Presidenciale
- Republike gjysme-  
presidenciale
- Republike  
Parlamentare
- Monarki kushtetuese  
parlamentare







**Monarki**



**Republikë**

# Rasti i Rumanise

Rumania është shtet unitar me **gati një republikë gjysmë-presidenciale**. Parlamenti ka dy dhoma: Dhomen e Lartë (Senatin me 140 anetare) dhe Dhomen e Ulet (me 346 deputete). **(Kushtetuta rumune ka si model Kushtetuten franceze të Republikës së V-të)**. Presidenti i Republikës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë për një mandat 5-vjeçar **(deri dy here)**. Ai emeron kryeministrin megjithatë fuqite i ka relativisht të kufizuara. Ai përgjigjet për politikën e mbrojtjes dhe të jashtme, emëron kryeministrin, por **nuk mund ta shkarkojë atë apo ta shpërndajë parlamentin**. Ky lloj sistemi i inspiruar nga ai francez është i shtrirë **deri diku** dhe në vende të tjera të Europës Lindore si **Polonia, Ukraina apo Bullgaria**. Ai synon deri diku ndarjen e fuqisë ekzekutive midis **presidentit dhe kryeministrit**. Në Rumani, gjysmë-presidencializmi i frymëzuar nga ai francez kombinohet me një sistem elektoral proporcional, që në ciklet e fundit elektorale ka prodhuar mazhoranca të zvogëluara.

**Rreziku për jostabilitet rritet kur shumica që zgjedh presidentin kthehet në minorancë parlamentare (Kohabitacioni- Rasti aktual: Konflikti midis presidentit Traian Basescu dhe kryeministrit Viktor Ponta )**

# Rasti i Lituanisë (?)

- **Lituanian konsiderohet si një republikë gjysmë-presidenciale.** Presidenti është kryetar i shtetit, ai zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë për një **mandat 5-vjeçar**, me mundësinë e dy mandateve të njëpasnjëshme. Ky post është me tipare të theksuara ceremonial; megjithatë me rol kryesor në funksionet politike të tilla si politika e jashtme dhe ajo e sigurisë kombëtare. Ai është Komandant i Përgjithshëm i FA-së. Po ashtu, me miratimin e parlamentit (Seimas) ai emëron Kryeministrin, dhe me emërimin e këtij të fundit, dhe pjesën tjetër të kabinetit qeveritar. Presidenti emëron drejtues të tjerë kryesorë të shtetit dhe gjykatësit e të gjitha niveleve.
- **Parlamenti është njëdhomësh** (Seimas) me 141 deputetë për mandate 4-vjeçar. 71 janë zgjedhur në mënyrë mazhoritare (në një zone zgjedhore) dhe 70 të tjerë në mënyrë proporcionale në nivel kombëtar. Pragu i përfaqësimit në parlament është 5% e votes kombëtare.
- **Gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese** shërbejnë për një periudhë 9-vjeçare. 3 prej tyre emërohen nga Presidenti, 3 nga kryetari i Seimas-it dhe 3 nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

# Shqipëria si republike presidenciale me dy dhoma

- Në periudhen e parë, Zogu nxiti **procesin kushtetues republikan**. Sipas Kushtetutës dega legislative u bë me dy dhoma: Dhoma e Deputetëve, e zgjedhur me votime të përgjithshme; Senati, në të cilin një të katërtën e zgjidhte Presidenti, ndërsa pjesa tjetër zgjidhej njëjloj si deputetët.
- **Presidenti i Republikës është në të njëjtën kohë edhe kryetar i Këshillit të ministrave**; njëjloj si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai krijon qeverinë dhe përgjigjet para Dhomës së deputetëve.

*(Pierre Chanlaine, "Pourquoi Zog I-er est aimé des albanais?" (Përse e duan shqiptarët Zogun e parë) botuar më 18 shtator 1928 në gazetën franceze "La Patrie")*

# Shqipëria sot

## • PJESA E PARË: PARIME THEMELORE

### Neni 1:

1. **Shqipëria është republikë parlamentare.**
2. Republika e Shqipërisë është **shtet unitar dhe i pandashëm.**
3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

### Neni 2:

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. **Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.**
3. Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtarë, Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### Neni 3:

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

### Neni 4:

1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.
2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

### Neni 5:

Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

### Neni 6:

Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

### Neni 7:

**Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.**


Neni 11:

1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet **në pronen private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.**
2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj.
3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Neni 13:

**Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.**


**Sovraniteti**



**Ndërvarësia**

**Qeverisja Vendore**

**Decentralizimi**



# Mekanika e Qeverisjes

**Per te nxjerre ne pah veprimtarine demokratike ne procesin e qeverisjes vlejne te theksohen:**



- ❖ **Cfare roli luan kushtetuta e vendit? Cila eshte pesha e vertete e saj?**
- ❖ **Si nderveprojne midis tyre trupi legjislativ me ate ekzekutiv?**
- ❖ **Cili eshte roli i gjyqesorit?**
- ❖ **Cila eshte forma e sistemit elektoral ne perdorim?**
- ❖ **Cili eshte roli i partive politike ne funksionimin e qeverisjes? Po ne lidhje me pushtetin ekzekutiv?**



# Kushtetetuta

## Cfare permбан ajo?



- **Eshte nje dokument i shkruar i adoptuar nga nje autoritet sovran, qe shpreh parimet dhe rregullat e organizimit shteteror;**
- **Apo qe permбан dhe parime e rregulla te pashkruara qe drejtojne strukturen politike**
  - **Vendimet dhe interpretimet juridike**
  - **Praktikat apo “zakonet” moderne politike**
  - **Konventat politike**

# Kushtetuta

- **Kushtetuta është ligji themeltar i një vendi**, me anë të cilit caktohet organi dhe rregullohet procedura e nxjerrjen së ligjeve. Ajo përmban rregulla juridike më të përgjithësuara dhe dispozitat e saj kanë fuqi më të lartë juridike në raport me dispozitat ligjore. **Pra, në këtë kuptim është ligj mbi ligje dhe ka vetinë e aktit më të lartë juridik, prej të cilit buron dhe mbështetet i tërë rendi juridik i vendit.** Fuqinë e saj juridike më të lartë e përcakton vet organi kushtetues nëpërmjet kushtetutës. Po ashtu, **kushtetuta ka dhe vetinë e aktit ideo-politik**, pra ajo është bazë jo vetëm për rregullimin por edhe ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore në një vend. Por, **kushtetuta është në vetvete dhe një akt programor-deklarativ.**

# Përmbajtja e kushtetutës

- Ajo varet nga vullneti i hartuesit dhe miratuesit të saj. Është ai (kushtetutbërësit) që përcakton përmbajtjen, strukturën, vëllimin dhe raportet midis pjesëve përbërëse apo çështjet tjera që rregullohen me kushtetutë. Ka raste, edhe pse jo të shpeshta, kur hartimi i kushtetutës nuk shpreh vullnetin e lirë të kushtetutbërësit por është pasojë e një marrëveshje. Përgjithësisht kushtetutat bashkëkohore përmbajnë këto pjesë: **Dispozitat e përgjithshme. Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe shtetasit. Organi legjislativ. Kryetari i shtetit (presidenti). Organi ekzekutiv. Organi gjyqësor. Ndarja territoriale dhe vetqeverisja vendore. Rendi dhe Mbrojtja. Forcat e Armatosura.**
- **P.sh., kapitulli kushtetues i lirive dhe të drejtave të njeriut, ka munguar në variantin e Kushtetutës së ShBA-së të vitit 1787; ai u plotësua 4 vjet më vonë me anë të 10 amendamenteve. Sot, të gjitha kushtetutat përmbajnë dispozita të rëndësishme mbi këtë çështje, ato mbi pushtetin shtetëror, madje shpesh dhe dispozita.**

# Përbërja (struktura) e kushtetutës-

- Kemi kushtetuta me pak faqe si ajo e Tajlandës e vitit 1959 me vetëm 30 nene dhe tre faqe tekst, apo shumë të vëllimshme si kushtetuta e Indisë e vitit 1949 e cila ka 395 nene dhe 9 shtojca me 131 faqe. Në strukturimin e shumicës së kushtetutave konstatohen: **Preambula** dhe **Pjesa normative**
- **Preambula** (lat.*preambulum* – hyrje) vendoset në fillim të kushtetutës, është e ndarë nga pjesa normative e saj dhe përgjithësisht është “sintetike” dhe e vazhduar (e pandarë në nene). Ka raste ajo përfshihet në kushtetutë në trajtën e parimeve themelore apo si deklaram mbi sistemin, mbi bazën ideore dhe pikësynimet e kushtetutës. **Ajo nuk ka efekt juridik, dhe përgjithësisht praktikohet në kushtetutat e miratuara pas revolucioneve, pas luftrave nacional-çlirimtare (p.sh., në kushtetutën e ShBA-së 1787, në atë të Shqipërisë së tranzicionit të vitit 1998 apo të Kosovës 2008).**
- **Pjesa normative** – paraqet pjesën qendrore pra dhe vetë përmbajtjen e kushtetutës së një vendi. Ajo është diskrete, e shënuar sipas neneve me numra, e ndarë në pjesë dhe kapituj (me përjashtim të kushtetutave të shkurta). **Në rastin e shteteve federative në kushtetutë përfshihen dhe pjesë të lidhura me njësitë federale (shtete, lande dhe kantone) dhe raportet midis organeve federative dhe njësive federale.**



# Kur nje kushtetute vleresohet “demokratike”?

- A promovon ajo “te miren publike”?
- A ka nje procedure te qarte per te ndryshuar kushtetuten?
- Deri ne c’ nivel e kufizon fuqine ekzekutive (qeverine)?
- Sa i specifikon ajo listen e plote te lirive dhe te drejtave individuale?



# “Kushtetuta” Britanike

- **Eshte nje kushtetute e pashkruar** (pra, nuk ekziston nje dokument i vecante i kodifikuar, si dhe disa burime te pashkruara)
- Pikenisja **Magna Carta** (1215) dhe me tej evoluim ne qindra vjet duke e kthyer Britanine ne nje **monarki kushtetuese/ sistem parlamentar**.
- Ndertim i nje **Supermacie Parlamentare**
- Zhvillon idene e Qeverisjes se Pergjegjshme, ku **dega ekzekutive jep llogari para asaj legjislative**.



# Bazat kushtetuese

- Mbretëria e Bashkuar është **shteti i vetëm evropian pa kushtetutë të përpiluar në një dokument të vetëm**. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që nuk ekzistojnë burime të cilat argumentojnë dhe shpjegojnë formën e sotme shtetërore të vendit. Në to bëjnë pjesë fondi i rregulloreve ligjore, konventat dhe shfaqjet e pranuar të parimeve kushtetuese (...).

## Bazat kushtetuese

- Substanca e “kushtetutës” britanike bazohet në dy parime: ***Rule of Law***, (***Zbatimi i ligjit***) që nënkupton detyrimin e veprimit shtetëror ndaj ligjit dhe **sovraniteti i parlamentit**.
- *Rule of Law* i mbron qytetarët nga veprimi arbitrar i shtetit dhe e detyron parlamentin t'u japë formë ligjore kompetencave të pushtetit qeverisës. **Ligjet mund të hiqen apo të ndryshohen me një shumicë të thjeshtë në parlament. Për ndryshimin e kushtetutës nuk janë të nevojshme shumica të veçanta, sepse nuk ekziston një dokument kushtetues.**
- "Realiteti kushtetues" që shprehet në gjendjen e legjislacionit, në këtë mënyrë është lehtësisht i ndryshueshëm dhe i përkulshëm.



# Sovraniteti i parlamentit

- Praktikën e “zhvillimit të përkulshëm” të kushtetutës e thjeshton tradita e drejtësisë angleze. Ajo bazohet në të drejtën zakonore (*common law*). Kriter kryesor i kësaj të drejte është bazimi i gjyqësorit në rastet precedente apo “cases”, pra në vendimet shembull, të cilat mund të përdoren për zgjidhjen e rasteve të reja dhe të cilat mund të zhvillohen më tej përmes ligjeve të reja. Pikënisje për vendimet juridike është përherë rasti konkret dhe jo një rregullë e përgjithshme. Përshtatja e ligjeve dhe e institucioneve të vendit gjatë shekujve u mundësua duke iu përgjigjur traditave angleze juridike dhe kushtetuese, kontinuitetit formal.
- Shtylla e dytë kryesore, përveç referimit të veprimit shtetëror në ligje, është sovraniteti i parlamentit. Parlamenti miraton ligjet dhe kontrollon ligjvënien, ndërsa vetë nuk bazohet në një tekst kushtetues të renditur. Parlamenti, e jo populli, është kushtetutë-vënës. Nuk ekziston gjykata kushtetuese, e cila të ketë mundësinë e rivendikimit të vendimeve të parlamenteve. Ekzistenca e saj nuk mund të mendohet pa një dokument kushtetues.
- Kushtetutat e shteteve demokratike zakonisht përcaktojnë ushtrimin e pushtetit shtetëror nga populli, pra sovranitetin e popullit. Si shpjegohet atëherë veçoria britanike e sovranitetit të parlamentit dhe çfarë rëndësie praktike ka ajo sot? Sovraniteti i parlamentit u arrit në të ashtuquajturin *Glorious Revolution (Revolucioni i Lavdishëm)* të viteve 1688/89. Ajo shënon fundin e konfliktit mes dinastisë sunduese katolike të Stuartëve dhe parlamentit protestant. Kjo u shoqërua me një paketë kushtëzimesh kushtetuese, të ashtuquajturit *Bill of Rights* (1689), që i dha fund sundimit absolutist në Britaninë e Madhe dhe themeloi monarkinë kushtetuese. Keshtu, i delegohen parlamentit të drejta të tilla si zgjedhjet, e drejta e lirisë së fjalës, e drejta e taksave, etj.
- Edhe pse në shek. XIX dhe XX, e drejta e përgjithshme, e barabartë, e lirë dhe fshehtë e zgjedhjes u realizua nga Partia Liberale, më saktë, nga partia parardhëse e saj *Whigs* si rezultat i kërkesave politike të borgjezisë, punëtorisë dhe lëvizjes së grave, pozita kushtetuese e parlamentit ndryshoi shumë pak, në kuptimin që qytetarët britanikë formalisht mbetën të sunduar nga mbretëresha. Pra, në Britaninë e Madhe, ndryshe nga Evropa kontinentale, nuk pati revolucione qytetare apo sociale apo lëvizje të tjera, të cilat do të rrëzonin apo të paktën do të detyronin një dokument kushtetues, i cili do t'i jepte karakter kushtetues sovranitetit të popullit .



# Udhëheqësi i shtetit dhe kabineti qeverises

- Mbretëria e Bashkuar është **monarki kushtetuese e trashëguar**. Kryetari i shtetit është mbreti (mbreteresa). Detyra e tij apo e saj është emërimi nepermjet propozimit te kryeministrit i anëtarëve të qeverisë, i peshkopëve të Kishës Anglikane (kishës shtetërore angleze), i gjykatësve supremë, ambasadoreve dhe i udhëheqësve të ushtrisë, qe betohen para mbretit. **Detyrat e monarkut janë të natyrës përfaqësuese, ceremoniale dhe unifikuese**. Mbretëresha e sotme Elizabeta II nga familja Hannover-Windsor-Mountbatten qeveris që nga viti 1952, ajo (më saktë familja mbretërore) përfaqëson vendin brenda dhe jashtë tij, dhe është drejtuese e Kishës Shtetërore Anglikane. Pozita e saj mbipartiake e bën atë një figurë kombëtare, përgjithësisht të pranuar, madje edhe në kohërat e luftërave dhe të krizës.
- Funkzioni më i rëndësishëm politik në sistemin britanik të qeverisjes është ai i kryeministrit. Kryeministrat britanikë kanë pushtet të madh, sepse **ata zotërojnë një potencial të madh emërimi e „partonazhi“**, i cili u jep mundësinë për emërimin p.sh. në poste ministrore të afro 100 deputetëve të partisë qeverisëse brenda dhe jashtë kabinetit të tij dhe në postet e tjera të qeverisë apo drejtuese të një sërë institucionesh publike, si p.sh. të sistemit shëndetësor, atij të komunikacionit dhe të BBC-së. Pushteti i tij bazohet ne parlament edhe në lojalitetin ndaj partisë së tij, kryetar i së cilës është vetë.
- Kryeministrat e sotëm, përkrahjen për politikën e tyre gjithnjë e më tepër e kërkojnë **duke kontaktuar drejtpërdrejt me popullin dhe me ndihmën e mediave**. Për "menaxhimin" e opinionit publik shfrytëzohet tradicionalisht sekreti dhe dhënia selektive e taktike e informacioneve. Për këte futet ne funksion dhe e ashtuquajtura gazetaria e lobingut. ( Për të hyrjë në "klubin" ekskluziv të rreth 150 gazetarëve, të cilët furnizohen çdo ditë me informacione "të besueshme" nga zëdhënësi i qeverisë, burimin e së cilave ata nuk duhet ta publikojnë, vendos qeveria). **Vetë Toni Bler, ne kohen e tij, e perfeksionoi ndikimin mbi mediat, duke mos i lejuar, në një rën anë, asnjë anëtar i kabinetit dhënien e deklaratave politike pa lejen e kryeministrit**, dhe, në anën tjetër, duke fuqizuar kompetencat dhe iniciativen e bashkëpunëtorëve të tij që merreshin me çështje publike ("**spin doctors**"), sidomos në fushata elektorale. Parlamenti, ashtu si rrethi i ministrave, tërhiqen në sfondin e një stili të tillë mediatik të personalizuar, të ngjashëm me atë të presidentit të SHBA-së.

# Qeverisja ekzekutive bazohet në disa parime tradicionale

Parimi i parë, pozita dominante e kryeministrit, në njërën anë përmban kompetencën e përcaktimit të kahut të politikës .


Përveç kësaj, roli i madh i kryeministrit ndikon edhe në proceset e vendimmarrjes brenda qeverisë. Kryeministri i ndan këto vendimmarrje në shumë segmente të kabinetit, të krijuara ad hoc, të kontrolluara prej tij apo të besuarve të tij. Këto procese të brendshme të vendosjes, shumë më tepër se në Gjermani, zhvillohen jashtë vëmendjes së opinionit publik. Edhe më e rëndësishme është aftësia e kryeministrit për ushtrimin e zgjeruar të pushtetit, i cili **nuk kufizohet as nga partnerët e koalicionit, as nga ndonjë tekst kushtetues, gjykatë kushtetuese, kryetar shteti apo parlament.**

Për këtë arsye, sistemi britanik i qeverisjes quhet edhe **qeveri e kryeministrit** (*prime ministerial government*) ose edhe "**dikataturë zgjedhore**" (*elective dictatorship*). Se si i shfrytëzon kryeministri përkatës mundësitë e tij të zgjeruara, kjo natyrisht varet nga personaliteti i atij që mban këtë funksion.

Margaret Theçer, në kohën e qeverisjes së saj si shefe konservatore e qeverisë nga viti 1979-1990, njihej për regjimin e saj të ashpër ndaj kabinetit dhe për vullnetin krijues, të bazuar në parime të forta politike. Toni Bler gjithashtu ushtroi një kontroll të ngjashëm mbi kabinetin e tij, edhe pse në **aspektin ideologjik** dukej **shumë më i papërcaktuar** se Margaret Theçer (...).

# Kushtetuta Amerikane

- **Kushtetute e shkruar ne 1787**
- Ne variantin origjinal ajo permban:
  - **Neni I: Kongresi**
  - **Neni II: Presidenti**
  - **Neni III: Gjykatesit dhe gjykatat kombetare**
  - **Neni IV: Struktura e sistemit federal**
  - **Neni V: Si amendohet Kushtetuta**
  - **Neni VI: Ndertimi i supermacise kushtetuese**
  - **Neni VII: Ratifikimi**
- Vendosjen e sistemit te **kontroll-balancimit**
- **10 amendamentet e para jane quajtur dhe “Bill of Rights” dhe te shtuara me 1791 (4 vjet me vone).**





# Kushtetuta Kanadeze

- **Nje kushtetute e shkruar dhe e pashkruar.**

- Ajo perfshin *kete “dosje”*:

- *Akti Kushtetues 1867*

- *Akti Kushtetues 1982*

- *Akti i Gjykates se Larte, 1875*

- *Statuti i Westminster, 1931*

- *Letrat e Patentes , 1947*

- *Akti i Emergjencave , 1988*

- *Aktet Federale qe pranojne Provincat ,*

Si dhe: Norma te ndryshme, konventa, vendime juridike apo statute qe konsiderojne perberese permanente te Pushtetit Ekzekutiv Kanadez.

- **Vendos nje sistem te qeverisjes se pergjegjshme (qe jep llogari para legjislatures).**
- **Akti Kushtetues, 1982 qe perfshin Karten e Lirive dhe te Drejtave.**

# Dy raste te kunderta dhe ai “hibrid”

Britania	SHBA	Kanada
- E pashkruar	- E shkruar	- Nje pjese e shkruar, nje pjese e pashkruar
- Unitare	- Federale	- Federale
- Parlamenti	- Republika	-Parlamenti
- Sinteze ekzekutiv - legjislature (Ilogari-dhenie)	-Ndarje e ekzekutivit nga legjislatura (kontroll/balance).	- Sinteze e ekzekutivit dhe e legjislatures (Ilogari-dhenie)
- <b>Supermaci Parlamentare</b>	- <b>Supermaci Kushtetuese</b>	** <b>Parlamentare deri me 1982,</b> ** <b>pastaj Kushtetuese</b>


**Pavarësisht çfarë pohohet në  
rastin e Kushtetutës shqiptare  
(apo në modelet e ngjashme të  
saj si modeli italian, grek, etj.)  
mishërohet **supermacia  
parlamentare...****

# Sistemet Elektorale

- Zgjedhjet janë **treguesi kyc** i natyres demokratike te nje shteti
- Per t'u konsideruar demokratike, krahas **nënkuptimit te lirisë se asocimit qe lejon formimin dhe organizimin e alternativave politike**, zgjedhjet kerkojne:
  - Zgjedhje te kandidateve
  - Zgjidhje te lira larg frikes dhe ushtrimit te forces
  - Votim universal (voton kushdo mbi nje moshe te dhene p.sh. **18 vjec**)
  - Te respektohet vota dhe numerimi i saj.
  - Te jene te rregullta te vendosura ne afate te arsyeshme



# Mosha per votim



Votimi: 16 17 18 19 20 21 25

Per votim moshë si 16 vjeç në Austri. Debatohet dhe në vende të tjera për të kaluar nga 18 në 16 vjeç. Në vende të tjera ndeshen moshë më të mëdha deri në 25 vjeç (Kube, Nikaragua, etj), apo **ne Itali per zgjedhjet senatoriale**. Kurse moshë për t' u zgjedhur në disa vende është përcaktuar më e madhe, p.sh. Në Moldavi për kryetarin e njësisë vendore 25 vjeç dhe keshilltarin 21 vjeç.



# Tipat e Sistemeve Elektorale

Zgjedhjet zhvillohen me një nga sistemet pasuese:


- **Sistemi mazhoritar**
  - Zgjidhet vetëm një nga kandidatët, kandidati fitues ka marrë më shumë vota (**me një raund apo balotazh**)

## **Sistemi i perziere**

- **Sistemi proporcional**

- përqindja e votave popullore e fituar nga një parti reflektohet në numrin e mandateve të fituara.

**Varianti rajonal** (p.sh., sistemi spanjoll).



# Demokracia e Drejtpdrejte

## Referendumet



- Për **adoptimin e një kushtetute** të re (si në Shqipëri, më 1994 dhe 1998), miratimin e **disa amendamenteve kushtetuese** (si p.sh. ai në Francë, në vitin 2000, për reduktimin e mandatit të presidentit nga 7 vjet në 5 vjet).
- **Zgjedhjen e një zyrtari të lartë, në veçanti kryetarin e shtetit (në mjaft vende, përfshirë dhe demokracitë e reja në Ballkan).**
- Aprovimin e **ndonjë ligji apo traktati, i disa masave me karakter administrativ, social apo ekonomik, etj.** (p.sh., referendumi i vitit 2005, në Brazil, për të vazhduar lejimin e tregtimit të armëve të zjarrit, apo ai i vitit 1967 në Australi për popullsinë autoktone të Australisë).
- Tipike janë rastet që lidhen me **shkëputjen apo vetëvendosjen** (si p.sh referendumi i vitit 2006 në Mal të Zi, ai i vitit 1991 në Kroaci, referendumet e përsëritura, në vitin 1980 dhe 1995, në provincën e Kebekut në Kanada, etj.).
- **Ndryshimin e sistemit politik**, si ai i vitit 1976 në Spanjë, pas vdekjes së Frankos apo i vitit 1997 në Shqipëri (për të ruajtur apo ndryshuar sistemin politik).
- Një tip tjetër referendumi është dhe ai i **miratimit popullor të një vendimi integrimi** si p.sh ai i Spanjës i vitit 1986 për anëtarësimin në NATO. Po kjo skemë u ndoq në disa vende të Evropës dhe për anëtarësimin e tyre në BE ose për **projekt-kushtetutën evropiane.**

**Mjaft të njohura janë referendumet e organizuara në vitin 2005, në Francë dhe Holandë, që hodhën poshtë traktatin apo projekt-kushtetutën evropiane.**




# Shembulli i Zvicres

**Kampione në lidhje me referendumet është Zvicra, e cila që nga kushtetuta e vitit 1848 deri në vitin 2006 ka organizuar 540 referendume federale (pra, në mesatare, 3-4 referendume në vit). Kurse, në nivel kantonal e lokal arrihet në një shifër mesatare të 10 referendumeve në vit.**

# Zvicra- 2-

- Cdo qytetar qe arrin **moshen 18 vjec** ka te drejten e pjesemarrjes (votim dhe kandidim) ne nje proces demokratik te drejtperdrejte ne Zvicer ose jashte saj (me poste). Nje nga kantonet ka qene me liberal duke e zbritur kete kufi per te votuar **ne moshen 16 vjec**. Zgjedhjet organizohen ne baze komune ku qytetaret e juridiksionit te saj regjistrohen ne menyre automatike me arritjen e moshes se caktuar. Cdo kanton zhvillon teste elektorale nepermjet internetit apo celularit ne nivel lokal. **Ritheksojme se ne demokracine direkte si instrumente kryesore jane iniciativat popullore (me zanafille me 1891) dhe referendumet opsionale (me 1874).**
- Iniciativa eshte p.sh. per te amenduar kushtetuten (pjeserisht apo plotesisht); kerkohen 100, 000 firma te mbledhura brenda 18 muajve qe nga dita e inicimit te procesit. **Pergjithesisht, iniciativat popullore hidhen poshte me vota, vetem afro 10 % e tyre kane arritur te miratohen ne periudhen 1891- 2010.**
- Referendumi u jep te drejte qytetareve zvicerane qe te votojne per nje legjislacion te miratuar paraprakisht ne parlament. Nje gje e tille sherben dhe si pergjegjesi e presion mbi ligjvenesit, sidomos me hedhjen poshte te nje ligji ne referendum. Nga ana tjeter kjo favorizon nje dinamike te favorshme te kontakti deputet-votues. **Ka dy tipe referendumesh: opsional (i lire apo me zgjedhje) dhe i obligueshem (i detyrueshem).**
- **Nje shembull:** Ne vitin 1996 u be nje referendum per kalimin e nje komune (me 70 veta) nga kantoni i Bernes ne nje kanton tjeter. **Kjo kerkese u miratua.**

**II. 3. Për një qeverisje të mirë**  
**a. Kufizime demokratike të**  
**pushtetit ekzekutiv.**  
**(rasti shqiptar)**



I lire



Pjeserisht i lire



Jo i lire

### Freedom House (viti 2009):

**PR (Te drejtat Politike):** procesi elektoral, pluralizmi politik dhe pjesëmarrja, funksionimi i qeverisjes.

**CL( Lirite Civile):** liria e shprehjes dhe e besimit, të drejtat e bashkimit dhe të organizimit, zbatimi i ligjit, autonomia personale dhe të drejtat individuale.

Shqipëria me tregues të PR-së 3 dhe të CL-së 3 klasifikohen si një vend **pjesërisht i lirë**. Në këtë kategori me po të njëjtat të dhëna futet po ashtu Maqedonia dhe Mal i Zi. Në po këtë grup ndodhet dhe Bosnie-Herzegovina me tregues përkatësisht 4 dhe 3, apo Moldavia me tregues 4 dhe 4. Në grupin e vendeve **të lira** në Ballkan janë klasifikuar me të njëjtët tregues 2 ( PR), 2 (CL) Bullgaria, Rumania dhe Kroacia. Kurse, për çudi për vitin 2009, në vendet e lira përfshihet dhe Serbia me tregues përkatësisht 3 dhe 2 (me mesatare të dy treguesve 2.5).

Në klasifikim me tregues 1, 1 ndodhet Sllovenia, ndërsa kemi për Greqinë treguesit 1, 2 dhe për Turqinë 3, 3.

# Shteti

Aristoteli në librin e tij “Politika” bën një analizë të hollësishme, për kohën e tij, lidhur me shtetin, që në të shumtën e rasteve ishte organizuar në atë periudhë të largët në bazë qyteti me periferinë e tij. Me anë të një paralelizmi të thjeshtë, ai arrin aty në përfundimin se *“format më të hershme të shoqërisë janë natyrore, i tillë është dhe shteti, sepse ai është qëllimi e fundi i tyre; e tillë është dhe natyra e gjithçkaje”* (Aristotel, *Politics, Book I, shkruar 350 p.e.s, perkthyer nga Benjamin Jowett*). Siç shihet, në këtë përcaktim, theksohet karakter natyror i shtetit, gjë që nënkupton dhe përkohshmërinë e tij.

**Shteti** (apo ai që, jo rrallë në mënyrë të vagët, në komunikimin kombëtar apo ndërkombëtar, quhet **vend**), shumë shpesh perceptohej e vazhdon të perceptohet mbi një bazë **territoriale e gjeografike**, pra më tepër si një territor i veçantë i populluar dhe me kufij plotësisht të përcaktuar. Por jo vetëm kaq, sepse **koncepti i shtetit ka dhe përmbajtje politike** që lidhet me **qeverisjen e këtij territori dhe të qytetarëve që banojnë aty**. Në këtë këndvështrim politik të shtetit, krahas territorit gjeografik e pushtetit qeverisës (apo **autoritetit politik e legjislativ**), bën pjesë dhe **pushteti gjyqësor** (apo sistemi juridik), që të konceptuar së bashku përbëjnë **sovrانيتin e shtetit**.

- R. Meidani, *Kurthet e shtetit-komb*, Toena, Tiranë 2005, f. 224.; R. Meidani, *Las trampas del Estado-nacion*, Siddharth Mehta Ediciones, Madrid 2007, f. 196.

# Sovraniteti

- **Sovraniteti** nënkupton një të drejtë ekskluzive për të ushtruar një autoritet të lartë, në një kohë të caktuar, mbi një territor apo rajon gjeografik, si dhe mbi një grup njerëzish, që së bashku formësojnë një komb ose disa kombe, apo janë anëtarë të një bashkësie, qoftë dhe në trajtë relativisht primitive.
- Ai, sot, zakonisht është i “mishëruar” në një qeveri demokratike apo në një strukturë tjetër politike – të konsideruar si **përfaqësuese të sovranitetit** të popullit, dhe që rrjedh nga një proces zgjedhor pluralist, i lirë dhe i drejtë, megjithatë ka ende raste, në të cilët ai ushtrohet edhe nga një individ i vetëm. I tillë është p.sh., ndonje monarki absolute në Lindjen e Mesme ku një monarku që drejton vendin sovran mund t’ i referohesh gjithashtu **si Sovran i këtij vendi...**



# Shteti, shteti-komb dhe rendi botëror

- **Shteti** nënkupton një zonë gjeografike dhe një organizim politik të pavarur, me institucionet e veta qeverisëse, me ligjet (shpesh dhe një kushtetutë), me administratën, policinë, sistemin e taksave dhe popullin që banon aty. Pra, vetë institucionet qeverisëse dhe banuesit e një territori të tillë, përbëjnë ose formësojnë **shtetin de jure dhe de facto**.
- Në kuadër të shtetit-komb, **kombi nënkupton një bashkësi njerëzish të njëjtit lloj, të organizuar politikisht nën një qeveri të vetme**; pra dhe grupin kryesor të njerëzve që jetojnë brenda një vendi; një federate, etj. Edhe pse sot shumë kombe e kanë vendin apo shtetin e tyre të pavarur, përsëri ekzistojnë edhe kombe e kombësi pa një shtet të tyre, siç janë p.sh. kurdët. Dhe shqiptarët janë copëzuar me të padrejtë, pas shpërbërjes së perandorisë osmane.
- **Sidoqoftë, koncepti i shtetit-komb, që shpreh një organizim specifik të shtetit, ka imponuar dhe një ndërtim të veçantë të rendit botëror. Shtetet-kombe janë shtete të hershme, të formuara nga “kombe” dhe të “ideuara” në fillimin e tyre në bazë të Traktatit të Vestfalisë të viti 1648 (Treaty of Westphalia, Munster, October 24, 1648, Translation: British Foreign Office).**
- Për më tepër, ideologjia e nacionalizmit e ka parë këtë “ndërtim” si rrugën e vetme legjitime për formësimin e shtetit. Nën ndikimin e “nacionalizmit” lingvistik dhe kulturor në lëvizjet e kaluara nacionaliste, përgjithësisht, shumica e shteteve-kombe ekzistuese janë pothuajse etno-nacionale; ata janë bashkësi të hershme “brezash” që përbëhen nga një grupim nacional kryesor dhe (ose jo) disa bashkësi më të vogla etnike, pra nga kombi “titullar” dhe (ose jo) disa minoritete etnike. **Në raste të veçanta mund të përdoret ky koncept i shtetit-komb edhe për konfiguracione shtetërore federative, të përbëra nga disa grupe kombëtare.**

# Shteti shqiptar

**Shqipëria është republikë parlamentare. Republika e Shqipërisë është shtet unitar (neni 1 i Kushtetutës). Sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7 i Kushtetutës).**

# 1. Pushteti Legjislativ

- Pushteti legjislativ i perket **Kuvendit te Shqiperise (Parlamenti)**. Kuvendi eshte nje dhomeshe dhe perbehet nga 140 deputete te zgjedhur çdo kater vjet.

(**me pare**: 100 deputete zgjidheshin direkt nga populli, nga nje anetar ne nje zone elektorale dhe 40 deputete ishin te zgjedhur nga lista shumeemeroe e partise apo koalicionit partiak, sipas renditjes ne to. Ky nen (64) eshte amenduar dhe ne zgjedhjet e vitit 2009 u be **kalimi ne sistemi proporcional rajonal**).

- Zgjedhjet per Kuvendin zhvillohen 60 dite deri ne 30 dite para mbarimit te mandatit dhe jo me vone se 45 dite pas shperndarjes se tij. Mandati i Kuvendit te Shqiperise vazhdon deri ne mbledhjen e pare te Kuvendit te ri. Ne kete kohe Kuvendi nuk mund te nxjerre ligje ose te marre vendime, me perjashtim te rasteve te vendosjes se masave te jashtezakonshme, (Neni 65 i Kushtetutes).

- **Deputet i Kuvendit mund te zgjidhet cdo qytetar qe ka mbushur moshen 18 vjec (nenit 45 i Kushtetutes). Nuk mund te kandidojne e as te zgjidhen deputet pa hequr dore nga detyra, keto kategori: a) gjyqtaret, prokuroret; b) ushtaraket e sherbimit aktiv; c) punonjesit e policise dhe sigurimit kombetar; d) kryetaret e bashkive dhe te komunave si dhe prefektet ne vendet ku kryejne detyrat e tyre; dh) kryetaret dhe anetaret e komisioneve te zgjedhjeve; e) Presidenti i Republikes dhe funksionaret e larte te administrates shteterore te parashikuar nga ligji (neni 69 i Kushtetutes). Deputeti nuk mund te ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit (neni 73 i Kushtetutes)- ndryshimi per imunitetin**

- **Keshilli i Ministrave, cdo deputet ose 20.000 votues mund te propozojne projektligje per t'u shqyrtuar nga Kuvendi.** Disa ligje te rendesishme, si ligji i zgjedhjeve, kerkojne nje shumice prej tre te pestash te te gjithe deputeteve per t'u miratuar. Ligji hyn ne fuqi pas nenshkrimimit nga Presidenti dhe botimi ne Fletoren Zyrtare (neni 81 i Kushtetutes).

# 2. Presidenti i Republikes

- Kryetari i shtetit eshte Presidenti, i cili zgjidhet nga Kuvendi me nje shumice prej tre te pestash per nje mandat pesevjecar.

**Amendamenti:** Pas 3 raundeve te para te pasukseshme (kerkohet mbi 60% e votave te anetareve te kuvendit) **zgjidhet ne fund me shumice te thjeshte te gjithe anetareve te parlamentit!...**

- Kur Presidenti i Republikes eshte ne pamundesi te perkohshme per te ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit ze vendin dhe ushtron kompetencat e tij (neni 87 i Kushteutes).

- Presidenti kryen funksionet baze te kryetarit te shtetit: caktimin e dates per zgjedhjet e pergjithshme parlamentare, ushtrimin e se drejtes se faljes, emerimin e Kryeministrit dhe ministrave, dekretimin (emerimin- konfirmimin) e gjyqtareve, pranimin e kredencialeve diplomatike, lidhjen e marreveshjeve dhe dekretimin e legjislacionit (neni 92 i Kushtetutes). Ne lidhje me kete te fundit, **Presidenti mund te vere veton mbi nje ligj vetem nje here** (neni 85/1 i Kushteutes). **Presidenti ushtron te drejten e dhenies apo heqjes se shtetesise.**

# 3. Pushteti Ekzekutiv

## a. Keshilli i Ministrave

-Keshilli i Ministrave eshte organi me i larte i pushtetit ekzekutiv dhe perbehet nga Kryeministri, zevendes kryeministri dhe ministrat. Kryeministri eshte Kryetar i Keshillit te Ministrave. Kryeministri emerohet nga Presidenti i Republikes ne fillim te legjislatures se Kuvendit, me propozim te partise ose koalicionit te partive qe ka shumicen ne Kuvend.

-Ministrat emerohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikes me propozim te Kryeministrit.

- Keshilli i Ministrave percakton drejtimet kryesore te politikës se pergjithshme shtetërore. Ai i merr vendimet me propozim te Kryeministrit ose ministrit perkates. Ne rast nevoje, Keshilli i Ministrave dhe ne kushte urgjence, mund te nxjerre akte normative qe kane fuqine e ligjit per marrjen e masave te perkohshme. Keto akte normative i dergohen menjehere Kuvendit dhe ne qofte se nuk miratohen prej tij brenda 45 diteve ato humbasin fuqine qe nga nxjerrja e tyre.

## b. Qeverisja Vendore

- Njesite e qeverisjes vendore jane qarqet, bashkite dhe komunat (Ligji Nr. 8652, 31.07.2000 Per Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore).

- Shqiperia ndahet ne 12 qarqe, 65 bashki dhe 309 komuna. Secila komune ose bashki dhe qark ka organet e veta te qeverisjes vendore.

- **Organi ekzekutiv i bashkise ose komunes eshte kryetari**, i cili zgjidhet me votim te fshehte, drejtperdrejt nga populli.

- Po ne kete menyre (por me sistem proporcional) zgjidhet edhe Keshilli, qe eshte organi perfaqesues i njesise se pushtetit vendor.

- Perfaqesues i qeverise ne qarqe eshte prefekti.

Decentralizimi dhe autonomia e pushtetit vendor parashikohen nga neni 13 i Kushtetutes.

Nenet 108-115 te Kushtetutes parashikojne te drejten e pushtetit vendor per te lidhur kontrata, mbledhur taksa, administruar te ardhurat dhe pronat e tyre ne menyre te pavarur dhe per te nxjerre akte me fuqi ligjore.

# 4. Pushteti Gjyqesor

**Pushteti gjyqesor zgjidh mosmarreveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjeve.** Ky pushtet ushtrohet nga **Gjykata e Larte, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Shkalles se Pare** (gjykatat e rretheve). Gjykatat ushtrojne keto tipe juridiksioni: **civil, penal, tregtar dhe administrativ.** (per kete te fundit eshte miratuar ne maj 2012 ligji per Gjykatën Administrative)

- Gjykata e Larte **ka juridiksion fillestar dhe rishikues.** Gjykata e Larte ka juridiksion fillestar ne rastet kur gjykon akuzat penale kunder Presidentit te Republikës, Kryetarit dhe anetareve te Keshillit te Ministrave, deputeteve, gjyqtareve te Gjykates se Larte dhe shqyrton (rishikon) ankimet ndaj vendimeve te gjykatave te shkalles se pare dhe apelit. Gjykata e Larte perbehet nga kolegje civile, penale dhe ushtarake dhe ka 17 gjyqtare te cilet emerohen ne detyre nga Presidenti i Republikës, me pelqimin e Kuvendit, per nje mandat 9 vjeçar te parinovueshem. - **Gjykata e Apelit eshte nje gjykate qe shqyrton ne shkalle te dyte te gjitha çeshtjet e gjykuara nga gjykatat e shkalles se pare, te cilat ankimohen nga palet ndergjyqese.** Ajo gjykon ne menyre kolegji me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare.

- Gjykata e Apelit gjykon çeshtjen ne teresi dhe nuk kufizohet vetem me shkaqet e paraqitura ne ankim. Gjykatat e Apelit funksionojne ne zona te caktuara nga Presidenti i Republikës me propozim te Ministrit te Drejtesise, pasi eshte marre edhe mendimi i Keshillit te Larte te Drejtesise. Aktualisht ekzistojne **gjashte gjykata apeli** te vendosuara ne rrethet: **Tirane, Shkoder, Durres, Korçe, Gjirokaster dhe Vlore**. Gjyqtaret e gjykatave te apelit emerohen ne detyre nga Presidenti i Republikës, me propozim te Keshillit te Larte te Drejtesise.

- **Gjykatat e Shkalles se Pare** funksionojne prane çdo rrethi gjyqesor (ne shumicen e rasteve) dhe kompetenca e tyre shtrihet ne te gjithë territorin e rrethit te cilit i perkasin. Gjykimet realizohen nga **nje gjyqtar** i vetem, por ne çeshtje te ndryshme mund te zhvillohen edhe gjykime ne **kolegje te perbera nga tre gjyqtare.** Aktualisht, funksionet e gjykatave ushtarake te shkalles se pare ushtrohen nga trupa gjykues prane gjykatave te rretheve gjyqesore, ndersa gjykata ushtarake e apelit ka funksionuar si gjykate me vete (me seli ne Tirane) deri ne pranvere 2010. (Sipas relacionit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave “**gjykatat ushtarake nuk e justifikojnë ekzistencën e tyre si nga pikëpamja funksionale ashtu edhe nga ajo ekonomike**”).

- **Kushtetuta ndalon krijimin e Gjykatave të Jashtëzakonshme.**

- **Keshilli i Larte i Drejtesise** perbehet prej Presidentit te Republikes, kryetarit te Gjykates se Larte, Ministrit te Drejtesise, 3 anetare te zgjedhur nga Kuvendi dhe 9 gjyqtare prej te gjitha niveleve te zgjedhur nga Konferenca Gjyqsore Kombetare dhe ka nje mandat 5 vjecar. Keshilli i Larte i Drejtesise eshte **organi qe emerone, transferon dhe percakton pergjegjesite e gjyqtareve ne baze te ligjit.**
- **Prokuroria** ushtron ndjekjen penale dhe perfaqeson shtetin ne gjykate. Prokurori i pergjithshem eshte emeruar nga Presidenti i Republikes dhe me miratim te Kuvendit (nenet 148 dhe 149 te Kushtetutes) dhe shkarkohet me propozim te tij. Prokuroria i ushtron kompetencat e saj ne menyre te pavarur duke iu nenshtruar vetem kushtetutes dhe ligjeve.  
- Policia Gjyqesore
- **Kontrolli i Larte i Shtetit** mbikeqyr aktivitetin ekonomik te institucioneve shteterore, perdorimin dhe ruajtjen e fondeve shteterore nga organet e qeverisjes qendrore e vendore dhe aktivitetet ekonomike te personave ne te cilat qeveria zoteron me shume se gjysmen e pjeseve ose aksioneve (ligjet 162-165 te Kushtetutes). Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit emerohet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim te Presidentit te Republikes. Mandati i tij eshte 7 vjecar.
- **4. Gjykata Kushtetuese**  
Ne veprimtarine e saj Gjykata Kushtetuese i nenshtrohet vetem Kushtetutes se Shqiperise. Ajo gezon pavaresi te plote organizative, administrative e financiare per realizimin e detyrave te caktuara me Kushtetute dhe me ligj. **Gjykata Kushtetuese perbehet nga nente anetare te zgjedhur nga rradhet e juristeve me kualifikim te larte dhe me pervoje pune jo me pak se 15 vjet ne profesion te cilet emerohen nga Presidenti i Republikes me pelqimin e Kuvendit dhe qendrojne ne detyre per nente vjet pa te drejte riemerimi.**

# Disa struktura te tjera

## Ne brendesi te deges gjyqesore

- Konferenca gjyqesore
- Zyra e buxhetit gjyqesor

## Ne varesi te Ministrise se Drejtesise

- Permbarimi ( tani edhe si aktivitet privat)
- Burgjet

## Institucione te tjera (“profesione te lira”)


- Noteria
- Avokatia




# ***Disa karakteristike negative të tranzicionit shqiptar***

Fuqia legale gjatë 20 viteve të tranzicionit nuk është ushtruar gjithnjë nga institucionet kushtetuese (dega ekzekutive, legjislative apo gjyqësore). Krahas tejkalimit të fuqisë së njërit pushtet apo tjetrit, kjo fuqi legale është zëvendësuar pjesërisht nga struktura të tjera të tilla si:


- **partitë politike**, forumet apo drejtuesit e tyre (mendësia e partisë-shtet);
- **forcat e sigurisë** (policia, garda, shërbimi informativ apo forcat e armatosura) si në rastin e krizës së piramidave financiare;
- **grupet financiare e ekonomike**, përfshirë dhe operatorë mediatikë si shprehje e **korrupsionit politik** dhe **kapilar**, apo e **konfliktit të interesave**;
- **faktorë të jashtëm**, në sajë dhe të paaftësisë apo kompleksit të inferioritetit të politikës shqiptare.



# *Kufizimi i pushtetit ekzekutiv në kuadër të demokracisë dhe lirisë. Domosdoshmëria e transparencës.*



1. Kufizimi kushtetueso-ligjor
2. Kontrolli parlamentar- institucional
3. Kufizimi politiko-partiak
4. Kontrolli juridiko-ekonomik
5. Kontrolli sindikalist ( +biznesi )
6. Kontrolli publik, shoqëria civile, media dhe pjesëmarrja qytetare



# 1. Kufizimi kushtetues-ligjor



Uillson (Woodrow Wilson):

“Historia e lirisë është historia e kufizimit të pushtetit qeverisës dhe jo i rritjes së tij”.

Së pari, kufizimi i pushtetit qeverisës realizohet në mënyrë **kushtetuese-ligjore**, nëpërmjet bashkëpunimit, ballancimit dhe kontrollit reciprok të pushteteve të ndryshme (Parimi i ndarjes dhe i kontroll-balancimit “**check and balance**“). Akumulimi i tyre është në kurriz të demokracisë.



## 2. Kontrolli parlamentaroinstitucional



Një rol shumë të rëndësishëm në kufizimin e pushtetit qeverisës luan **kontrolli e kufizimi parlamentar**, sidomos kjo në kuadrin e një republike parlamentare.

Krahas grupit parlamentar të mazhorancës, për sqarime, rregullime, ndërhyrje e korigjime, ndryshime kabineti, një rol jo më pak të rëndësishëm duhet të luajë dhe opozita.

( **interpelanca** për çështje konkrete, **inisiativa ligjore** në mbështetje të zhvillimit apo në shërbim të grupimeve të caktuara qytetare, **mocione të ndryshme** për raste individuale, deri dhe **komisionet parlamentare** për çështje tepër madhore e serioze, etj.). **Mocioni i besimit dhe ai i mosbesimit per kryeministrin?**

**Por jo „shfaqje“ politike apo komisione te bollshme pa asnje rezultat!**

**As kartone servile apo pa pergjegjshmeri politike-juridike! As vonesa te pakuptimta per dekrete qe duhen votuar ose jo!**





### 3. Kufizimi politik-partiak

Në kushte normale, **kufizimi i pushtetit qeverisës** realizohet **politikisht** si nga forca politike apo koalicioni i partive në qeverisje, sepse një gjë e tillë është në detyrimin programor e interesin e tyre politiko-elektoral, ashtu dhe nga partitë opozitare nëpërmjet angazhimeve të larmishme. Në terma të kufizuara, mund të flitet dhe për **partitë e koalicionit**, strukturat drejtuese të të cilave, pas ndarjes së “copërave” të qeverisjes mbeten pothuajse krejtësisht jashtë loje në mbarëvajtjen e punëve apo në orientimin e drejtë e kolegjal të tyre. Me mungesë efektiviteti shfaqet dhe opozita.

**-Bashkepunim i domosdoshem pozite-opozite per ceshje kardinale.**





- I. **Konflikti dhe perplasja politike midis partive.**
  - **Korrupsioni politik. Blerja e votes. Mungesa e transparences ne finacimin e partive, sidomos gjate fushatave zgjedhore. Korruptimi ne strukturat e votim- numerimit. Mikro e megadushku shqiptar.**
- II. **Probleme te brendshme.**
  - **Mungesa e demokracise se brendshme. Mungesa e vizionit demokratik. Ushtrimi i forces jo ekuilibri i forcave. Mangesi ne zbatimin e frymes se kolegjalitetit. Njeshi absolut! Uniformitetet dhe jo solidaritet ne diversitet...**
- III. **Mangesi ne konfiguracionin dhe reformimin politik.**
  - **Klasifikime artificiale te kraheve-mungesa e ndryshimeve parimore. "Satelitizmi" me partite e vogla, etj.**
- IV. **Raporti biznes-politike. Konflikti i interesave.**

**Njeshi absolut!**



**Fuqia absolute**





# Lidershipi i partise jo nje “black hole” apo “worm hole”!




- Mosfunksionimi i fraksioneve Mungesa e debatit real dhe e mendimit apo analizes individuale.
- Mungesa e idealizmit.

**-Probleme besimi**



# Imoraliteti politik, sipas rajoneve









# NDI- Shqiperi 2005

Motivimi i Politikanëve






### Shkalla e Korrupsionit - NDI 2005




## Ndershmëria kundrejt Korrupsionit

Publiku i gjerë 2008



# Ndershmëria kundrejt Korrupsionit

Publiku i gjerë kundrejt Sektorit publik 2008




# Ndershmëria kundrejt Korrupsionit

Krahasim në vite (vetëm ato institucione që shfaqin ndryshime)

Shumë  
i korrupthuar

■ Publiku i gjerë 2005 ■ Publiku i gjerë 2006 ■ Publiku i gjerë 2008





# Vendet me te prekura nga mitmarrja

(Perqindje e te pyeturve qe kane dhene para nen dore ne nje periudhe 12 muajshe: 2007-2008)



## Me shume se 40%:

Shqiperia, Kameruni, Gaboni, Maroku

## 16-40%

Bolivia, Kongo, Republika Ceke, Republika Domenikane, Greqia, Indonezia, Kenia, Meksika, Moldavia, Nigeria, Paraguai, Peruja, Filipinet, Rumania, Senegali, Ukraina, Venezuela.

## 6 - 15%

Argjentina, Bullgaria, Kili, Kolombia , Kroacia, Hong Kongu, India, Kosova, Luksemburgu, Maqedonia, Pakistani, Panamaja, Rusia, Serbia, Tailanda

## 5% ose me pak

Austria, Kanada, Danimarka, Fixhi, Finlanda, Franca, Gjermania, Islanda, Izraeli, Japonia, Malejzia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Singapori, Afrika e Jugut, Koreja e Jugut, Spanja, Suedia, Zvicra, Tajvani, Mbretetria e Bashkuar, ShBA.


Burimi: Transparency International Global Corruption Barometer



# Treguesi i perceptimit të korrupsionit (CPI-International Transparency)

- **CPI “mat” nivelin e perceptuar të korrupsionit në sektorin publik.** Ai është një indeks kompleks, bazur në vrojtime të ndryshme ekspertësh dhe biznesit. Për vitin 2008 analizohet dhe rradhitet i njëjti numër prej 180 vendesh si në vitin 2007, në shkallën dhjetëshe nga zero ( krejtësisht i korruptuar) në 10 (plotësisht i pastër).
- *Danimarka, Zelanda e Re dhe Suedia kanë treguesin më të lartë të ndjekur nga Singapori me 9.2. Kurse në rreshtin e fundit janë Somalia me tregues 1.0, e ndjekur nga Iraku dhe Birmania me 1.3 dhe Haiti me tregues 1.4.*
- **CPI-ja mesatare për vitin 2008 rezulton 6,5 për 27 vendet e BE-së (5.6 në 12 vendet e reja anëtare).** Kurse në vendet e Evropës Jug-Lindore ky tregues është 3,5.

**Treguesi i perceptimit te korrupsionit (CPI) ne vendet e Evropes  
(2003-2008)**





# Mbi korrupsionin

- *R. Meidani,*
- *“Kontradikta” korrupsion-liri ekonomike,* gazeta “Shekulli”, 30 tetor 2005, f. 1, 15.
- *“Përplasja” korrupsion- liri ekonomike,* Gazeta “Panorama”, 30 tetor 2005, f. 1, 17.
- *Lufta kundër korrupsionit - edhe çështje e vullnetit politik,* gazeta “Shekulli”, 5 nëntor 2005, f. 1, 15.
- *Korrupsioni, pamje politiko-ekonomike,* gazeta “Shekulli”, 7 nëntor 2005, f. 1, 15.
- *Korrupsioni zgjedhor dhe kodi etik,* gazeta “Shekulli”, 9 nëntor 2005, f. 1, 15.
- *Korrupsioni- alternativa për të minimizuar rastet e tij,* gazeta “Shekulli”, 14 nëntor 2005, f. 1, 15., etj.



## 4. Kontrolli juridiko-ekonomik

- Gjykatat (Gjykata e Faktit, e Apelit dhe Gjykata e Larte, Gjykata Kushtetuese)
- Prokuroria.
- Avokati i Popullit.
- KLSH.
- Banka e Shqiperise.
- Entet rregullatore (p.sh., per politikat e çmimeve, ose ERT qe aktualisht quhet **AKEP - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare**)
- Inspektorati i Larte i deklarimit te pasurive.
- Aautoriteti i konkurrences.
- Sherbimi civil
- Etj.

Po ketu imuniteti e forcon apo e dobeson rolin e tyre?!



## 5. Kontrolli sindikalist (+biznesi)

Në kushtet e reja të riorganizimit ekonomik e shoqëror, të rritjes së rolit të prodhimit të vogël e të mesëm, të shoqëruar me shpërndarjen dhe mikrostrukturimin e fuqisë punëtore, janë shfaqur dobësi të theksuara në **lëvizjen sindikaliste**, në mbrojtje të interesave të punëmarrësve përkundrejt punëdhënësve **privatë** ose **publikë**.

-Dobësi të rolit dhe forcës së kësaj lëvizjeje në kufizimin e pushtetit qeverisës.

- Nevoja për një vizion të ri në **reformimin** e kësaj lëvizjeje në kushtet e reja.

-Krahas mungesës së energjisë dhe orientimit, shfaqet edhe një **frymë konformizmi**. (P.sh. “**heshtja sindikaliste**” në momente të tilla,, siç është p.sh. ai i mosrritjes së rrogave për të gjitha kategoritë e punonjësve, të parashikuar në buxhetin e vitit 2003, i rritjeve të rrogave pa mbuluar inflacionin, ai i rritjes së tarifave për shërbime të ndryshme përfshirë atë të energjisë).

-Jo pa vlerë është dhe reagimi i **organizmave punëdhënësve private** dhe i bashkimeve të tyre, përfshirë dhe **Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë**, ndaj trysnive e veprimeve të padrejta e arbitrare të pushtetit qeverisës, në dëm të biznesit korrekt me ligjin e sistemin rregullator.



## 6. Kontrolli publik, shoqëria civile, media dhe pjesëmarrja qytetare



Xhefersoni (Thomas Jefferson), mbi rolin kontrollues e kufizues të medias së lirë mbi pushtetin qeverisës, ka nënvizuar:

**“Asnjë qeveri nuk duhet të jetë pa çensurues; dhe aty ku shtypi është i lirë, asnjëra prej qeverive nuk mund të mbetet pa atë”.**

Një rol gjithnjë në rritje në një sistem demokratik luan dhe kontrolli e reagimi publik, i sintetizuar si një **reagim mediatik, qytetar apo ai i shoqërisë civile**, në përgjithësi. Pavarësisht, disa shformimeve të shfaqura dhe në **median** tonë, disa pozicioneve diku konformiste, diku abuzive apo dhe me lidhje interesi, në mesatare ajo përsëri mbetet një zë me vlerë në zhvillimet tona. Po aq i rëndësishëm është shfaqur aty-këtu roli dhe ndikimi i disa OJF-ve apo strukturave të tjera të shoqërisë civile.



# Roli qytetar dhe ai i konsumatorit

-Roli i qytetarit nuk mbaron ne procesin zgjedhor.


-Kontrolli i rendesishem midis dy procesese (kerkim llogarie, kundervenie ndaj nje qeverisje te keqe qendrore e vendore per nje gamë të gjerë çështjesh, nga e drejta për siguri njerëzore dhe garantimin e një minimumi jetik e mirëqenieje, deri tek e drejta për ndarje të barabartë të trashëgimisë sociale, sidomos për çështje thelbësore si **edukimi, kujdesi shëndetësor e ruajtja e mjedisit.**

-Mund të veçohen dy aspekte të qytetarisë sociale:

- a) ai i **“nevojave” bazë**, ku edukimi dhe shëndeti mbeten parësorë
- b) **“integrimi social”**, që lidhet me punësimin, luftën ndaj varfërisë dhe pabarazisë së theksuar midis individëve apo rajoneve të ndryshme.

(Nuk mund të mohohet se problemet e rënda ekonomiko-sociale, në një përqindje të konsiderueshme të popullsisë, krijojnë barriera serioze për zhvillimin e **qytetarisë demokratike e sociale**, duke furnizuar kështu deri **kontingjente “fanatikësh”** në një fushatë zgjedhore apo dhe shtresime **“materialisht të manovrueshme”** gjatë e pas tyre).

**-Roli i konsumatorit**



# **b. Indikatorë të qeverisjes së mirë**

**Janë të rëndësishme marrëdhëniet e kontrollit, ku kanë vlerë parësore:**

**Fuqia**

**Ndikimi**

**Autoriteti**

**Legjitimiteti**

**Rakordimi, (lidhja e hallkave përkatëse)**

**Indikatorë të qeverisjes së mirë  
si ato të lidhura me:...**

**Drejtimin, administrimin**

**Shpërblimin**

**Kontrollin**

**Mobilizimin**

**Kapacitetin**

**Akoma!**

**...në çfarë niveli? Në atë të:**

**Mikro - agjensive apo strukturave të  
ndryshme**

**Fushave ndërmjetëse (si edukimi,  
transporti, ...) në nivel vendor**


**Makro – qeverisjes si e tërë.**

# Të lidhura me qeverisjen e mirë

- **Besimi i qytetarëve**
- **Zbatimi dhe respektimi i ligjit**
- **Prodhime efektive dhe programe gjithë-përfshirëse.**
- **Kontrolli demokratik**
- **Tërheqje e investimeve të huaja të drejpërdrejta. (FDI)**



## Axhenda e Lisbonës- performanca e sektorit publik si i tërë



# Në lidhje me administrimin publik

## *Alokacion burimesh*

- Në fushën e shëndetit
- Në fushën e edukimit
- Në ulje të varfërisë, papunësisë apo nivelit të krimit
- Shfrytëzim burimesh shtesë


## *Cilësia e administratës publike*

- Përmasa e burokracisë
- Transparenca (sondazhe me qytetarët, anketa, etj.)
- Efektiviteti i ndërhyrjeve qeveritare (implementimi)
- Korrupsioni

# **...me ç'mënyrë arrihet një qeverisje e mirë? Me anë të:**

- **Organizimit**
- **Rregullimit të brendshëm të punës në agjensi, apo në sektor**
- **Rregullimit të jashtëm**
- **Efektivitetit të përdorimit të burimeve: ekip (staf), teknologji**
- **Kërkimit dhe zhvillimit**
- **Drejtimit**
- **Kontrollit**
- **Etj.**

# Rendimenti dhe efektiviteti



# Zbatimi i ligjit

Vendimmarrje  
korrekte

Në përputhje me  
ligjin,

Identike

E parashikueshme

Proces i  
drejtë

Trajtim korrekt

Transparencë

Staf kompetent

Apelimi

Mundësia e  
apelimit

Mundësi për të  
paditur qeverinë

# Demokracia

Kontrolli politik

Ndikimi i qytetarëve

Shërbim civil luajal

Organizim luicid

Vendime objektive

Transparencë dhe hapje

Mjete efektive të drejtimit dhe kontrollit

Mjetet e ndikimit të drejtpërdrejtë

Një administratë e koordinuar mirë dhe fleksibël

Informacioni mbi preferencat e qytetarëve

Mundësi të përgjegjshme


Informim i përgjithshëm mbi shoqërinë

Qendrim demokratike

# Permbledhje:



## Zbatimi i ligjit



## Demokracia



	<b>Efienca&amp; efektiviteti</b>	<b>Ligji, njohja dhe zbatimi i tij</b>	<b>Demokracia</b>	<b>Rritja ekonomike</b>	<b>Kooperimi ndërkombëtar</b>
<b>Organizimi</b>	<b>X</b>				<b>X</b>
<b>Rregullimi i brendshëm</b>	<b>X</b>		<b>X</b>		
<b>Rregullimi i jashtëm</b>		<b>X</b>		<b>X</b>	
<b>Burimet: Stafi (personeli), teknologjia</b>	<b>X</b>			<b>X</b>	
<b>Drejtimi</b>	<b>X</b>				
<b>Kontrolli</b>					
<b>Etj.</b>				<b>X</b>	<b>X</b>



# Qeverisja e mirë

- **Qeverisja e mirë** një prioritet i politikës (**zhvillimi me plan, transparenca, lufta kundër korrupsionit, etj.**)
- **Qeverisja e mirë për çfarë?** - në ndërtim e mbrojtje të institucioneve, në respektim e garanci të drejtave të njeriut, në zgjedhje të drejtimit politik, në promovimin e përgjegjshmërisë, në sigurimin e të mirave publike, zgjidhjen e konflikteve, cilësinë e shërbimeve të ndryshme, etj.; më tepër barazi në terma të ndikimit, oportuniteteve, sigurisë dhe garancisë personale, të drejtave dhe gjykimit gjyqësor, etj.; rritje ekonomike dhe administrim duke respektuar të drejtën e pronës, garantuar paqen dhe mbrojtjen e jetës, luftën kundër korrupsionit, etj.
- **Implementimi i politikave të drejta, por ama si?**
- **Decentralizimi dhe rrugë të tjera të mirëqeverisjes**
- **Rrjeti strukturor i qeverisjes**

# Qeverisja e mirë për çfarë?

- Për një ndërtim e mbrojtje të institucioneve, në respektim e garanci të drejtave të njeriut, në zgjedhje të drejtimit politik, në promovimin e përgjegjshmërisë, në sigurimin e të mirave publike ( si zgjidhja e konflikteve, shërbimet e ndryshme, etj.; më tepër barazi në terma të ndikimit, oportuniteteve, sigurisë dhe garancisë personale, të drejtave dhe gjykimit gjyqësor, etj.; rritja ekonomike dhe qeverisja duke respektuar të drejtën e pronës, paqen dhe mbrojtjen e jetës, korrupsionin, etj.,
- Për përgjegjësitë konkrete e në nivelin qendror e vendor si harmonizimi i politikave, politikat dhe legjislacioni, propozimet e buxhetit (taksat dhe shpenzimet), miratimi i buxhetit dhe më tej implementimi i tij
  - Dhënia e llogarisë, raportimi dhe auditimi
  - Partnerë: parlamenti, qeveria qendrore apo vendore, shërbimi civil, shoqëria civile, sektori privat, donatorët, etj.
- Promovimi i qeverisjes së mirë është promovimi i ndryshimeve sociale. (si mund të promovohen ndryshime në partneritet, duke pasur parasysh cili e ka fuqinë, pronësinë, elementët ushqyers dhe mbështetës të ndryshimit)
- Identifikimi i oportuniteteve për sukses: kapacitetet konkrete dhe vullneti politik

# Implementimi i politikave për një qeverisje të mirë

- **Partnerët**
  - Menazhimi i asistencës / bashkëpunimit ndaj/ midis partnerëve
  - ”Përafrimi i shtrirjes së gjerë të vetë qeverisjes
  - Identifikimi i partnerëve të duhur
- **Roli i rëndësishëm i këshillimit:**
  - Çështje çelës në debatimin e politikave
  - Përcaktimi i drejtimeve kryesore në qeverisje
  - Informimi në lidhje me politikëbërjen për garantimin e strategjive realiste
  - Arritje e përftim, komunikim rezultatesh

# Decentralizimi dhe axhustimi

- **Më shumë fleksibilitet, vendimmarrje më e shpejtë, harmonizim më i mirë**
- **Më tepër fokus në çështje strategjike**
- **Nevoja për **strategji konkrete** në zbatim të politikave të zhvillimit**
- **Nevoja për rënien dakord në çështje çelës mbi praktikat e mira në mbështetje të një qeversije të mirë në fusha të ndryshme**

**Pse jo dhe **agjentifikimi** ne kuader te centralizimit e privatizimit ne sherbimet publike!**